



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.3.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe Financat për datën 20 shkurt 2021

2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës të dekretit të Presidentit të Republikës nr.11979, datë 24.02.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 16/2021 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare Tirana International Aeroport sh.p.k “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004”, të ndryshuar”.

3. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së madhe dhe Irlandës së Veriut”.

4. Seancë dëgjimore me kandidatët e vetofruar për pozicionin e një anëtari të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Eljo Hysko, Vullnet Sinaj, Reme Lala

Mungojnë:

Artur Roshi, Suzana Topi.

Të ftuar:

Bledar Dervishaj - këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore

Ketrin Treska - drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Juridik

Vasilika Vjero - zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Edmond Ahmeti - drejtor i Koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Belinda Balluku – ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Vjola Ademi - sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - drejtor Juridik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Të nderuar kolegë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e këtyre çështjeve:

Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe financat për datën 20 shkurt 2021.

Shqyrtimin në cilësinë e komisionit përgjegjës të dekretit të Presidentit të Republikës nr.11979, datë 24.02.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 16/2021 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare Tirana International Aeroport sh.p.k “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004”, të ndryshuar”. Relator është Anastas Angjeli.

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së madhe dhe Irlandës së Veriut”. Relatore është zonja Senida Mesi.

Seancë dëgjimore me kandidatët e vetofruar për pozicionin e një anëtari të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, e cila është kompetencë e Komisionit të Ekonomisë. Relator është Anastas Angjeli.

Në postën elektronike keni të gjitha materialet lidhur me këtë çështje.

Para se të fillojmë me çështjen e parë, miratimin e procesverbalit dhe më pas shqyrtimin e dekretit të Presidentit, do të bëjmë apelin: Anastas Angjeli, prezent, Arben Elezi, prezent, Antoneta Dhima, prezent, Blerina Gjylameti, prezent, Ervin Bushati, prezent, Rolant Xhelilaj, prezent, Xhevit Bushaj, prezent, Senida Mesi, prezent, Vullnet Sinaj, prezent, Krenar Rryçi, Selami Jenishehri, prezent, Korab Lita prezent, dhe Suzana Topi, prezent.

Kalojmë te çështja e parë e rendit të ditës, te miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe Financat për datën 20 shkurt 2021. Në postën elektronike u është vënë në dispozicion procesverbali. Ka ndonjë vërejtje apo sugjerim lidhur me procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet me të gjitha votat.

Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi, në cilësinë e komisionit përgjegjës të dekretit të Presidentit të Republikës nr.11979, datë 24.02.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 16/2021 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare Tirana International Aeroport sh.p.k “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004”, të ndryshuar”. Për të prezantuar shkurtimisht dekretin e Presidentit të Republikës, për arsye se na është dërguar me shkrim i plotë dhe shumë i hollësishëm, në emër të Presidentit, sot kemi të ftuar: zotin Bledar Dervishaj, këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore, dhe zonja Ketrin Treska, drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Juridik.

Mirë se erdhët!

Në emër të Ministrisë së Financave, në cilësinë e hartuesit dhe propozuesit kemi sot të ftuar: zonjën Vasilika Vjero, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, dhe zotin Edmond Ahmeti, drejtor i Koncesioneve në këtë ministri.

Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi prezent: zonjën Belinda Balluku, ministre, zonjën Vjola Ademi, sekretare e Përgjithshme, dhe zotin Enea Karakaçi, drejtor Juridik.

Relator për këtë çështje jam caktuar unë, dhe para se t’u jap fjalën përfaqësuesve të Presidentit, më lejoni të theksoj faktin se Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka depozituar pranë Kuvendit dekretin nr. 11979, datë 24.02.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 16/2021 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare Tirana International Aeroport sh.p.k “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004”, të ndryshuar”.

Bazuar në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit, ky dekret është futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 86, 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit, e merr në shqyrtim këtë dekret vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetim “Për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës”, pra rishikimi i tij do të fokusohet vetëm në këto dispozita.

Edhe një herë do të kërkoja mirëkuptimin e përfaqësuesve të Presidencës, edhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës, zonjës Ministre dhe zonjës zëvendësministre në Ministrinë e Financave që diskutimet të jenë sa më të fokusuara vetëm në çështje që kanë të bëjnë me argumentet që Presidenti i Republikës ka argumentuar kthimin me dekret të këtij projektligji, sepse edhe presidenca na i ka dërguar në mënyrë të hollësishme me shkrim, edhe të dyja ministritë gjatë diskutimit në komisione kanë argumentuar qoftë problemin e ndikimit në qëndrueshmërinë financiare të këtij komisioni, por në të njëjtën kohë, edhe argumente të tjerë ligjor dhe kushtetues për veprimet e ndërmarra që janë të pasqyruara në projektligj.

Fjala për përfaqësuesen e Presidencës, zonjën Ketrin Treska.

Ketrin Treska – Përshëndetje!

Arsyetimi për kthimin e këtij ligji është 43 faqe, dhe ne sigurisht kemi bërë një përmbledhje, kështu që në fillim do të flas unë dhe më pas do t'ia lë fjalën zoti Derivshaj.

Jemi përpjekur të bëjmë një përmbledhje, më pak se gjysma, por është një ligj që kërkon vëmendje, ndaj kërkojmë durimin tuaj.

Para së gjithash, më duhet t'ju theksoj se konstatojmë me keqardhje që vendimmarrja dhe procedura e ndjekur nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë ka qenë në shkelje të parimit për të ushtruar veprimtarinë shtetërore në mënyrë transparente. Mungesa e transparencës konstatohet që prej fillimit të këtij procesi të iniciuar pranë organit shtetëror të autorizuar, përfaqësuar nga dy ministritë përgjegjëse dhe deri në ditën e shqyrtimit të këtij ligji nga Presidenti i Republikës. Të dy ministritë përgjegjëse kanë hezitur t'i përcjellin kreut të shtetit informacionin e plotë administrativ të krijuar gjatë procesit të paraqitjes dhe të vlerësimit të kërkesës për ndryshimet e kontratës koncesionare, negociimin, dakordësimin apo konsultimin e kësaj nisme legislative.

Rezulton se nisma është depozituar në Kuvend nga Këshilli i Ministrave në datën 27 janar 2021, vetëm 1 ditë, pasi është nënshkruar para noterit aktmarrëveshja ndryshuese e kontratës së koncesionit. E njëjta procedurë urgjente është ndjekur edhe në Kuvendin e Shqipërisë, pavarësisht se Këshilli i Ministrave në vendimin propozues nuk ka kërkuar shqyrtimin e nismës me procedurë të përshpejtuar, sipas nenit 83 të Kushtetutës.

Kjo nismë është shqyrtuar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në cilësinë e komisionit përgjegjës, në datën 4 shkurt 2021 dhe rezulton se po në të njëjtën ditë kjo nismë është shqyrtuar edhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e

Njeriut, si komision për dhënie mendimi, ndërkohë që miratimi në seancë plenare është realizuar në datën 8 shkurt 2021, pra vetëm 4 ditë më pas.

Ligji është propozim i Këshillit të Ministrave depozituar në Kuvend në datën 27 janar përmes vendimit nr. 34, datë 27.1.2021. Projektligji i përcjellë Kuvendit, i miratuar si propozim nga Këshilli i Ministrave në datën 27 janar, ka bashkëlidhur aktmarrëveshjen me nr. 461 Repertori, nr. 188 Koleksioni, të nënshkruar në Kamzë në datën 26 janar 2021, pra vetëm 1 ditë para miratimit.

Para së gjithash konstatohet se procedura e ndjekur nga Kuvendi, më duhet ta theksoj, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 83, pika 2 të Kushtetutës, në të cilin citohet: “Kuvendi me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të 1/5 së të gjithë deputetëve mund të shqyrtojë dhe të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se 1 javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit”, ndërkohë që procedura e shqyrtimit kishte nisur vetëm 4 ditë më parë kur seanca plenare ka miratuar ligjin.

Po ndalem te një përmbledhje e problematikave të konstatuara.

Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare kur relatohen argumentet justifikuese mbi nevojën e ndryshimit të marrëveshjes bazë rezulton se procedura e ndjekur nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë deri në miratimin e këtij ligji paraqet disa problematika thelbësore.

Procedura dhe zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë në shkelje të parimeve kushtetuese të konkurrencës së lirë dhe të ndershme, barazisë përpara ligjit, kërkesave të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe në kundërshtim me vetë kushtet e marrëveshjes bazë të koncesionit që është lidhur që në vitin 2004.

Procedura dhe zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë pa garë, është bërë pa prituri përfundimin e koncesionit për të hapur një garë të re transparente.

Procedura dhe zgjatja e afatit të kontratës koncesionare vjen në kundërshtim me standardet dhe vlerat e Bashkimit Europian dhe parashikimet e vetë Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit plotësimi i të cilave është detyrim parësor për Republikën e Shqipërisë.

Procedura dhe zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë brenda një kohe rekord, *de facto*, me procedurë të përshpejtuar në shkelje të nenit 83, pika 2 të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.

Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare ndryshon kushtet thelbësore të kontratës koncesionare bazë, duke shmangur procedurën ligjore për hapjen e një gare të re dhe për pasojë ka cenuar të drejtën e operatorëve për pjesëmarrjen në konkurrim.

Arsyet që çuan qeverinë të zgjidhte si opzion më optimal zgjatjen e afatit të kontratës koncesionare ekzistuese, duke bërë negociata vetëm me një shoqëri dhe duke propozuar vetëm disa rregullime të pjesshme, në vend që të kërkonte një ofertë të re publike dhe të zgjidhte me një procedurë të hapur një ofertë me terma më përfituese për të përmbushur prioritetet e saj në drejtim të zhvillimit të transportit ajror apo kostove të udhëtarëve vlerësohet se janë të pambështetura, jorealiste dhe rezultat i një procesi të paracaktuar pro qeverisë.

Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë pa një analizë mbi seriozitetin dhe qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë që ka blerë aksionet e infrastrukturës së vetme funksionale aeroportuale ndërkombëtare në vend.

Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë brenda një kohe të shkurtër pas blerjes së aksioneve ndaj shoqërisë, që sipas të dhënave në regjistrat publikë të Qendrës Kombëtare të Biznesit, referuar në këtë rast, ka regjistruar barrë siguroese mbi kuotat e saj për përmbushjen e detyrimeve të mbartura.

Për pasojë, zgjatja e afatit të kontratës koncesionare nuk merr në analizë objektive interesin publik, që përfshin si sigurinë kombëtare, si sigurinë për ofrimin e një shërbimi të pandërprerë dhe të pacenuar aeroportual, ashtu edhe interesin financiar të vendit.

Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare që nga mënyra se si është hartuar dhe nënshkruar aktmarrëveshja shkel jo vetëm legjislacionin në fuqi për koncesionet, por shmang edhe zbatimin e një sërë ligjesh të tjera. Po ndalem t’ju përmend vetëm disa prej tyre si ligji “Për noterinë”, ligji “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë” dhe ligji “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë pa vlerësuar në mënyrë të thelluar pozitën dominuese, që mund të krijojë në fushën e transportit subjekti përfitues, jo vetëm në shërbimet në fushën e transportit ajror, por edhe në sektorë të tjerë që lidhen me infrastrukturën strategjike të vendit.

Ky ligj, për të gjitha këto arsye që ju përmenda më sipër, nga shpejtësia me të cilën është miratuar, ka tregues të qartë të fenomenit të përsëritur të asaj që quhet korrupsion legjislativ, që në këtë rast ka përfshirë si qeverinë ashtu edhe Kuvendin, sepse është fakt që brenda një dite

është mobilizuar i gjithë shteti në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe të ligjeve të vendit, për të bërë të mundur zgjatjen e afatit të koncesionit për aeroportin “Nënë Tereza”, që është një nga asetet më të rëndësishme dhe strategjike të shtetit me rëndësi për sigurinë kombëtare.

Megjithatë, po kaloj në disa detaje konkrete, të cilat i vlerësoj si të rëndësishme. Projektligji i përcjellë Kuvendit është miratuar si propozim i Këshillit të Ministrave, siç jua thashë në datën 27 janar, ka të bashkëlidhur aktmarrëveshjen nënshkruar vetëm 1 ditë para miratimit pranë një noteri në Kamzë të lidhur midis këtyre palëve, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shoqërisë *Tirana International Airoport*.

Referuar përmbajtjes së aktmarrëveshjes së nënshkruar nga palët nuk del qartë nëse të dy personat anëtarë të qeverisë, të dy përfaqësuesit, ministrja dhe zëvendësministri, janë paraqitur në datën 26 janar 2021 pranë noterit me vendndodhje në Kamzë apo jo.

Është për t’u theksuar që ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, përcakton në nenin 20 të tij, do t’ju përmend vetëm një fjali të dispozitës: “Noteri, nuk mund të hartojë akte ose të kryejë veprime noteriale jashtë bashkisë për të cilën është licencuar për të ushtruar veprimtarinë”.

Këshilli i Ministrave apo përkatësisht të dy ministrinë e ngarkuara në cilësinë e OSHA-së e kanë selinë e tyre në territorin e Bashkisë Tiranë, ndërsa referuar ekstra aktit historik të shoqërisë në QKB, kjo shoqëri e ka adresën në Durrës. Pra, asnjëra prej tyre as Këshilli i Ministrave dhe as shoqëria nuk kanë lidhje me bashkinë e Kamzës.

Data e nënshkrimit të marrëveshjes, elementi tjetër që vlen për t’u theksuar, gjendet vetëm në faqen e parë të aktmarrëveshjes, në formën e datës që gjenerohet automatikisht nga sistemi që kanë në përdorim noterët për redaktimin e akteve noteriale. Ndërsa në faqen 9 të kësaj kontrate, në dispozitën nr. 8 “Nënshkrimi”, që është dhe dispozita më e rëndësishme, nuk gjendet e përcaktuar data e nënshkrimit, edhe pse data e nënshkrimit/angazhimit të palëve për dakordësinë e arritur është element me rëndësi të veçantë për procesin dhe aktmarrëveshjen në tërësi.

Një element tjetër me rëndësi është se në përmbajtje të kontratës dhe bashkëlidhur saj mungon referenca, nëse nënshkruesit e aktmarrëveshjes kanë qenë të pajisur me autorizimin e lëshuar nga Këshilli i Ministrave për nënshkrimin e aktmarrëveshjes me këtë përmbajtje.

Verifikimi i mbajtjes së tagrit ligjor të përfaqësimit të Këshillit të Ministrave për të hyrë në një marrëdhënie juridike është element kryesor përpara hartimit dhe nënshkrimit të një akti

noterial. Nga shqyrtimi i praktikës dokumentare të përcjellë nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por edhe nga vetë përmbajtja e aktmarrëveshjes, nuk rezulton që palët nënshkruese, që kanë përfaqësuar Këshillin e Ministrave, të kenë qenë të pajisura me autorizim për nënshkrim nga ky i fundit. Edhe duke iu referuar bazës ligjore të përzgjedhur nga vetë qeveria dhe Kuvendi (neni 121 i Kushtetutës), është e detyrueshme pajisja me autorizim për negocim dhe nënshkrim.

Por edhe referuar nenit 7, të ligjit nr. 9312/2004, që ka miratuar kontratën e koncesionit bazë, parashikohet qartësisht se Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Ministria e Ekonomisë (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë) autorizohen vetëm të negociojnë dhe të arrijnë marrëveshje me shoqërinë koncesionare. Referuar këtij parashikimi, këto dy ministri nuk kanë tagrin t'i nënshkruajnë këto marrëveshje, për të cilat nevojitet një autorizim i posaçëm. Tagrin për të autorizuar nënshkrimin e marrëveshjeve ndryshuese e ka Këshilli i Ministrave ose Kryeministri. Një dokument i tillë nuk rezulton i lëshuar dhe administruar në praktikën shkresore.

Kontrata koncesionare e nënshkruar në vitin 2004 përmbante kushtin e ekskluzivitetit për operimin e aeroportit, kusht që nënkuptonte se qeveria shqiptare garantonte se gjatë afatit të koncesionit nuk do të licencohej, autorizohej dhe operohej asnjë aeroport tjetër. Pavarësisht faktit se ky kusht u rinegociua në vitin 2016, në aktmarrëveshjen ndryshuese nuk adresohet dhe nuk sqarohet se si do të rregullohet në vijim aeroporti i premtuar, sipas planit strategjik të qeverisë, në Kukës apo në Vlorë. Kjo duke marrë në konsideratë veçanërisht zgjatjen prej 13 vitesh, që i është bërë kontratës koncesionare, në raport me zgjatjen 2-vjeçare, që u dakordësua për operimin e aeroporteve të tjera dhe lejimin e fluturimeve ndërkombëtare.

Kjo çështje ka mbetur tërësisht e papërcaktuar në kontratën e koncesionit, pas ndryshimit përmes aktmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Për më tepër, aktmarrëveshja ndryshuese nuk parashikon dhe nuk mundëson uljen e tarifave. Nuk jepet asnjë sqarim nëse ulja e tarifave do të vijë si rezultat i uljes së pagesave ndaj shtetit apo kufizimit të konkurrencës; nuk flitet për konkurrencë për liberalizimin e fluturimeve; nuk përcaktohet dhe del qartë në marrëveshje nëse lejimi i konkurrencës për tarifën aplikohet dhe për udhëtarët dhe për shërbimet; në objektivat e saj marrëveshja koncesionare lejon vetëm lirinë e hyrjes në tregun e shërbimeve në tokë, pr mbetet e paqartë se për cilat shërbime bëhet fjalë: bëhet fjalë vetëm për shërbimet tregtare apo

edhe për shërbimet e furnizimit me hidrokarbure të flotës së pajisjeve të fluturimit, ku koncesionari ka pozitën dominuese në treg?

Më tej lidhur me procesin e ngutshëm që ka ndjekur Këshilli i Ministrave dhe më pas Kuvendi për miratimin e kësaj marrëveshjeje, neni 105, pika 2, i ligjit nr. 110/2018, përcakton se: “Akti noterial hartohet nga noteri në prani të palëve”, dhe kjo dispozitë rendit elementet e detyrueshme që duhet të përmbajë një akt noterial.

Ndërkohë që aktmarrëveshja e nënshkruar nuk përmban: orën fillimit apo të mbarimit të aktit; asnjë përshkrim të hollësishëm të rrethanave, gjendjes së palëve që nënshkruajnë aktin, si dhe çdo element tjetër që ndodh në prani të noterit, për të verifikuar nëse palët kanë qenë personalisht të pranishme në Kamzë, për redaktimin dhe nënshkrimin e tij apo jo; ekzistencën e autorizimit që duhet të ishte referuar me attribute të sakta (numër dhe datë), e duhet t'i ishte bashkëlidhur aktit; faktin që noteri ua lexoi palëve aktin dhe se nënshkrimi u bë në prani të noterit.

Ekzistencën dhe identifikimin në mënyrë të shprehur të këtyre elementeve në aktin noterial, neni 137, i ligjit për noterinë, e lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë me pavlefshmërinë e aktit. Konkretisht, neni 137, shkronja “e”, e ligjit nr. 110/2018, parashikon se akti noterial është hartuar pa u respektuar rregullat e parashikuara në pikën 2, të nenit 105, të këtij ligji e bëjnë aktin të pavlefshëm.

Pavarësisht mungesës së të dhënave të mësipërme në përmbajtjen e aktmarrëveshjes, që prezumohet se është redaktuar dhe nënshkruar para noterit, evidentohet se marrëveshja është nënshkruar në datën 26.01.2021. Ndërkohë që miratimi nga Këshilli i Ministrave në mbledhjen e qeverisë i propozimit të projektligjit dhe përcjellja në Kuvend i aktmarrëveshjes së nënshkruar, është bërë ditën e nesërme, në datën 27.1.2021. Në këtë kohë kaq të shkurtër është e paqartë se kur të dy ministritë përgjegjëse kanë proceduar me përgatitjen e praktikës; nëse kanë zhvilluar proces konsultimi, sipas kërkesave të ligjit; kur kanë marrë mendimin e ministrive të linjës për draft marrëveshjen e dakordësuar, sepse është element i detyrueshëm konsultimi; kur kanë bashkë nënshkruar propozimin dhe e kanë përcjellë pranë Këshillit të Ministrave; kur është shqyrtuar propozimi dhe përgatitja për shqyrtim në mbledhjen e datës 27.1.2021 të Këshillit të Ministrave.

Asnjë ministri nuk ka dhënë përgjigje për këto çështje. Propozimi i këtij ligji është miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 34, datë 27 janar 2021. Ligji është depozituar

po brenda ditës me urgjencë në Kuvend nga qeveria, po në datën 27 janar 2021. Dhe po në të njëjtën ditë, më 27 janar 2021, rezulton që Konferenca e Kryetarëve të jetë mbledhur dhe ta ketë përfshirë nismën ligjore të qeverisë në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 8-26 shkurt 2021.

Nga ana tjetër, rezulton se për shqyrtimin e këtij propozimi Kuvendi ka ndjekur realisht procedurë të përshpejtuar, ndërkohë që nuk kuptohet dhe justifikohet as qëllimi dhe as urgjenca e Këshillit të Ministrave si propozues, apo e Kuvendit të Shqipërisë, si miratues, në miratimin e këtij akti ligjor me kaq urgjencë procedurale dhe pa zhvilluar asnjë konsultim paraprak apo vlerësim të thelluar për një çështje kaq sensitive.

Në relacionin e Këshillit të Ministrave, që shoqëron propozimin, nuk ka asnjë arsyetim se cili është shkakun që qeveria po nxitonte në këtë proces me kaq rëndësi me sensibilitet të lartë publik.

Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare të publikuar nuk rezulton që Këshilli i Ministrave t'i ketë kërkuar Kuvendit të Shqipërisë shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar, referuar nenit 83, pika 2, të Kushtetutës. As në relacionin e Këshillit të Ministrave dhe as në raportin e komisionit përgjegjës nuk rezulton i arsyetuar se përse ky projektligj është përfshirë në procedura parlamentare në mënyrë të përshpejtuar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 83, pika 2, të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Edhe vetë Kuvendi i Shqipërisë në seancë plenare për miratimin e këtij ligji nuk është mbështetur te neni 83, pika 2, të Kushtetutës, por ka përdorur si bazë nenet 78, 83, pika 1 dhe, 121, pika 1, të Kushtetutës, duke shmangur bazën ligjore të shqyrtimit të këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar.

Për më tepër, ajo që bie në sy, edhe pse u ndala dhe theksova kaq herë nenin 83 të Kushtetutës, është fakti se në të njëjtën ditë me depozitimin kjo nismë është përfshirë në kalendarin e punimeve të kuvendit për periudhën 8-26 shkurt 2021. Kalendari i punimeve të kuvendit përmbante 30 nisma të renditura, ku jo për të gjitha është përcaktuar data e shqyrtimit në seancë plenare. Ndërsa për këtë kontratë koncesionare, që u miratua me ligjin nr. 16/2021, që sapo ishte depozituar në Kuvend. Po atë ditë Kuvendi caktoi datën e shqyrtimit të saj në seancë plenare 11 shkurt 2021. Për më tepër, pavarësisht se planifikimi ishte për datën 11 shkurt, miratimi i tij u bë disa ditë më herët, në datën 8 shkurt në seancë plenare. Pra, nga sa më sipër, rezulton se Kuvendi e ka nisur shqyrtimin e kësaj nisme në datën 4 shkurt, me shqyrtimin në dy komisionet parlamentare, dhe e ka miratuar në seancën plenare të datës 8 shkurt. Në këto kushte

miratimi i nismës është bërë brenda katër ditëve nga nisja e shqyrtimit të saj në kundërshtim flagrant me parashikimet e nenit 83, pika 2, të Kushtetutës. Mjafton vetëm ky fakt për të evidentuar ngutën në miratimin e kësaj nisme, nevoja e së cilës vijon të mbetet e paqartë dhe trajtohet edhe më në hollësi, në arsyetimin e dekretit që ka përcjellë Presidenti i Republikës.

Vetë ligji nr. 9312/2004, që ka ratifikuar marrëveshjen bazë të koncesionit, bazohet në tre dispozita kushtetuese, në nenet 78, 83 dhe 121 të Kushtetutës. Po ashtu, edhe ligji nr. 55/2016, që amendoi këtë kontratë, bazohet në të njëjtat dispozita. Por kjo ka një shpjegim, sepse shoqëria koncesionare "Tirana Airport Partners", sh.p.k., në vitin 2004 dhe në vitin 2016 zotërohej nga aksionarë joshqiptarë. Ndërkohë që miratimi i ndryshimit të kontratës së koncesionit, me ligjin nr. 16/2021, objekt shqyrtimi, nuk kishte pse të nënshtrohej nenit 121, pika 1, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", kur shoqëria koncesionare tashmë nuk ka më asnjë element të huaj, pasi aksionet zotërohen nga një shoqëri me shtetas shqiptarë, referuar ekstraktit historik të shoqërisë, publikuar në QKB. Pra, aktmarrëveshja ndryshuese, që është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe miratuar nga Kuvendi, në bazë të nenit 121 të Kushtetutës, nuk ka më asnjë element ndërkombëtar. Për më tepër, nëse do të kishim një element ndërkombëtar, duhej të respektohej një procedurë tjetër, sipas ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare. Pra, praktika duhet të ishte shoqëruar me vendimin e miratimit në parim dhe me mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit, si kërkesë specifike e ligjit "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Këto akte dhe autorizimi për nënshkrimin e marrëveshjes mungojnë në praktikën parlamentare, por dhe në praktikën dokumentare të përcjellë nga Kryeministria dhe dy ministrinë, pas kërkesës së institucionit të Presidentit të Republikës.

Shkurtimisht do të ndalem edhe tek anashkalimi i procedurës ligjore dhe dispozitave e parimeve bazë kushtetuese në vlerësimin e nevojës për ndryshimin e kësaj marrëveshjeje.

Ndryshimi kryesor i marrëveshjes koncesionare konsiston në amendimin e pikës 2.2 të tekstit të marrëveshjes bazë, që është dakordësuar të ndryshohet me këtë përmbajtje: "Koncesioni jepet për një afat kohor prej 35 vjetësh, duke filluar nga data e fillimit". Sipas këtij parashikimi të ri, afati për përfundimin e koncesionit të aeroportit të Tiranës të jetë viti 2040 dhe jo më viti 2027, siç ishte parashikuar. Pra, praktikisht, shoqëria koncesionare do të vijojë

marrëdhënien koncesionare edhe për 13 vjet të tjera shtesë, pas vitit 2027, që përkon me përfundimin e afatit të kontratës bazë lidhur në vitin 2004 dhe rinegociuar në vitin 2016.

Procedurat që duhet të ndiqen për t'u finalizuar më pas me një marrëdhënie koncesionare apo për të ndryshuar një marrëveshje ekzistuese koncesionare janë të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”.

Në nenin 31 i ligjit nr. 125/2013 parashikon shprehimisht: “Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë. Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës, që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën, kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës koncesionit apo të partneritetit publik- privat...”. Nuk po e lexoj të gjithë dispozitën, por kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar qartë se cilat janë kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për ndryshimin e kontratës së koncesionit. Në këtë procedurë të ndjekur rezulton se janë anashkaluar detyrimet e nenit 31 të ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”. Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare me 13 vjet është në vetvete më shumë se gjysma e afatit të përgjithshëm të kontratës bazë, të nënshkruar në vitin 2004. Ndërkohë që afati i kontratës bazë të koncesionit, prej 22 vjetësh është përcaktuar përmes konkurrimit të hapur, tashmë me ligjin nr. 16/2021, ky afat shtyhet edhe për 13 vjet të tjera, por pa asnjë konkurrim. Pra, kemi të bëjmë me një ndryshim aq thelbësor, që lidhet drejtpërdrejtë me shtrirjen e gjerë në kohë të mbajtjes dhe shfrytëzimit të drejtave koncesionare mbi këtë aset kombëtar, sa e gjithë procedura duhet t'i ishte nënshtruar një konkurrimit të ri.

Nëse afati 35-vjeçar do të kishte qenë i përfshirë në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, sigurisht që oferta e pjesëmarrësve do të ishte thelbësisht e ndryshme, përfshirë këtu dhe angazhimet për investimet në infrastrukturë. Hyrja në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë, pa garë, duke shkelur kërkesat e ligjit për koncesionet, që rregullon këtë veprimtari, duke pranuar apriori një kërkesë të koncesionarit, kërkesë për të cilën nuk jepet asnjë e dhënë, si për datën kur është depozituar, ashtu edhe për mënyrën se si është argumentuar dhe vlerësuar nga OSHA, shkel parimet kushtetuese të barazisë përpara ligjit dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve, parime këto që gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga nenet 11 dhe 18 të Kushtetutës.

Moszhvillimi i një procesi transparent, si dhe vendosja e tij nën ombrellën procedurale të shpeshtë së një kontrate koncesionare, ka shmangur konkurrencën e lirë, ka shkaktuar trajtim preferencial, ka cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe nuk garanton përfitime maksimale për financat e shtetit dhe interesin publik.

Ligji nr. 16/2021 miraton një aktmarrëveshje të nënshkruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 31, të ligjit për koncesionet dhe neneve 11 dhe 18 të Kushtetutës.

Për më tepër, vetë Kuvendi i Shqipërisë, përmes ligjit nr. 9312/2004, ka ratifikuar marrëveshjen bazë koncesionare, ku në nenin 7 ka sanksionuar: janë dy ministritë përgjegjëse që autorizohen të negociojnë dhe të arrijnë marrëveshje me shoqërinë koncesionare për ndryshimin e afateve dhe të kushteve të kontratës së koncesionit, me kërkesë të palëve kontraktuese, por vetëm nëse ndryshimet e propozuara përmbushin një sërë kushtesh, që renditen në nenin 7 të ligjit. Pra, përveç kufizimeve që sanksionon neni 31 i ligjit për koncesionet dhe vetë ligji ratifikues i kontratës koncesionare, kërkon përmbushjen e disa kushteve kumulative për ndryshimin e afatit apo kushteve të kontratës së koncesionit, të cilat jo vetëm që nuk plotësohen në rastin konkret, por as është menduar të vlerësohen nga qeveria dhe Kuvendi, që përkundrejt këtyre kërkesave kanë vepruar me kaq urgjencë për miratimin e ndryshimit të kontratës koncesionare. Ndërkohë që as në relacionin shoqëruar dhe as në raportet e komisioneve parlamentare, apo gjatë diskutimit të nismës në komisione dhe në seancë plenare, nuk evidentohen:

Arsyet e shkeljes së procedurës ligjore për zgjatjen e afatit të kontratës së koncesionit.

Analiza që është kryer dhe që mbështet faktin se kohëzgjatja e kontratës me 13 vjet është në funksion të politikës publike dhe interesave kombëtare.

Mënyra se si është administruar dhe vlerësuar kërkesa e koncesionarit për zgjatjen e afatit.

Llojin e analizës që është bërë për këtë qëllim, institucionet e përfshira në këtë analizë dhe rezultatet e dala dhe analizën mbi impaktin në pozitën financiare të vendit.

Procedura dhe zgjatja e afatit të kontratës koncesionare vjen në kundërshtim edhe me standardet dhe vlerat e Bashkimit Evropian dhe parashikimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), plotësimi i të cilave është detyrim parësor për Republikën e Shqipërisë.

Procedura e ndjekur për lidhjen e kësaj marrëveshjeje shpeshtë koncesionare, bie në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe akteve të dala në zbatim të tij.

Siç u evidentua më sipër, marrëveshja ndryshuese e koncesionit, që njeh të drejta të reja për subjektin koncesionar, rezulton të jetë nënshkruar në datën 26 janar 2021; të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 27 janar 2021; të jetë depozituar në Kuvend nga Këshilli i Ministrave po në datën 27 janar 2021; të jetë shqyrtuar në Konferencën e Kryetarëve dhe të jetë përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit po në datën 27 janar 2021; të jetë shqyrtuar në dy komisionet parlamentare në të njëjtën ditë, në datën 4 shkurt 2021, dhe të jetë miratuar më shpejt se sa parashikimi; të jetë përfshirë në seancën plenare në datën 8 shkurt 2021, ndërkohë që ishte parashikuar të shqyrtohej në datën 11 shkurt 2021. Përfundimisht është miratuar në seancën plenare në datën 8 shkurt 2021. Pra, përpos shkeljeve kushtetuese në procedurën e miratimit të përshpejtuar të ligjit, ky ligj bie në kundërshtim edhe me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe të akteve të dala në bazë të tij. Në bazë të Kodit Zgjedhor, ka dalë vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, që në nenin 3, pika 4, të tij thuhet: “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit, për të cilat nuk është bërë njoftimi publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe të nisur apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor”. Në rastin konkret, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë kanë shkelur në mënyrë flagrante parashikimet e Kodit Zgjedhor, duke nënshkruar një ndryshim të kontratës koncesionare që jep praktikisht një koncesionin të ri edhe për 13 vjet të tjerë, pa bërë një njoftim publik më parë dhe pa qenë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe të nisur.

Kjo është më se e qartë, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se i gjithë procesi i negocimit për ndryshimin e marrëveshjes koncesionare ka nisur pasi shoqëria shqiptare përfituese ka blerë aksionet e shoqërisë koncesionare “*Tirana International Airport*”, blerje kjo e finalizuar në fillim të muajit dhjetor 2020.

Për më tepër, në relacion është shprehur qartë se ky projektligj nuk ka qenë i parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2021 të Këshillit të Ministrave. Në këto kushte, përveçse ky miratim është bërë në shkelje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin e proceseve zgjedhore, Kuvendi as ka denjuar që t’i kërkojë sqarime qeverisë për këto çështje:

- Duke mos qenë nismë e parashikuar në programin analitik të projektakteve, përse qeveria është mjaftuar vetëm me një kërkesë të një koncesionari për hartimin dhe miratimin e zgjatjes së marrëveshjes, pa pritur përfundimin e kontratës, rihapjen e garës dhe paraqitjen e

kërkesave të tjera?

- Përse u ndërmor nisma për këtë amendim kontrate jashtë programit dhe planit strategjik të të dyja ministrive përgjegjëse, për më tepër u përbyll procesi negociues dhe nënshkruet pak më shumë se një muaji, pasi aksionet e shoqërisë koncesionare u transferuan 100% në një subjekt tjetër tregtar, ndërkohë që Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” konsiderohet si një nga asetet me rëndësi kryesore dhe strategjike të vendit?

- Cila është arsyeja reale që qeveria arriti në bindjen e plotë se propozimi i ortakut të ri, shoqërisë “*Tirana International Airport*” ishte propozimi më i mirë, ndërkohë që transaksioni i ndryshimit të pronësisë së kësaj shoqërie sapo kishte ndodhur? Kjo ndodhi në muajin dhjetor dhe e gjithë procedura u përbyll me miratimin e ndryshimit të kontratës koncesionare nga Kuvendi në datën 8 shkurt 2021.

- A ka pasur një shprehje interesi nga shoqëria koncesionare “*Tirana International Airport*” për zgjatje të afatit të koncesionit përpara tjetërsimit të kuotave tek aksioneri shqiptar? Nëse po, si është trajtuar ajo?

- Pse qeveria në mënyrë të vazhdueshme harton dhe propozon projektligje, të cilat nuk janë në përputhje me programet e shpallura dhe me strategjitë sektoriale dhe kombëtare, por vendos të ndërmarrë propozime për ndryshime ligjore menjëherë sapo paraqitet një kërkesë, ndërkohë që asnjë rrethanë nuk dikton nevojën urgjente për realizimin e procesit në mënyrë të përshpejtuar?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve rezultojnë të mos jenë dhënë as nga Këshilli i Ministrave dhe as nga Kuvendi i Shqipërisë gjatë shqyrtimit të nismës. Edhe në seancën plenare, gjatë diskutimit dhe miratimit të këtij ligji, nuk ka pasur asnjë debat apo diskutim real lidhur me këto çështje.

Unë po ia kaloj fjalën zotit Dervishaj për përbylljen e arsyeve të kthimit të këtij ligji.

Bledar Dervishaj – I nderuar kryetar dhe anëtarë të komisionit, duke ju kërkuar edhe ...

Anastas Angjeli – Zoti Dervishaj, duke falënderuar Ketrinën që jua kaloi fjalën, por fjalën jua jap unë, sepse komisionin e drejtoj unë, zonja Ketrin.

Ju kërkoj ndjesë për këtë.

Bledar Dervishaj – Është vijimi i arsyetimit të dekretit.

Anastas Angjeli – E di që është vijimi i arsyetimit të dekretit, por ka një rregull komisioni që të mos na thoni pastaj se është korrupsion legjislativ mosrespektimi i Rregullores për dhënien e fjalës. Kështu që, para se t’jua jap fjalën, do t’ju lutesha shumë që, meqenëse

materiali është shpërndarë në mënyrë elektronike, të jeni sa më konciz.

Fjala për ju.

Bledar Dervishaj – Ju falënderoj, kryetar, edhe për kujtesën!

Në vetvete ashtu është, pasi materiali është shumë i gjatë dhe shpresoj të jetë lexuar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Anastas Angjeli – Unë për të qenë i hapur dhe transparent po ju jua jap fjalën, pasi jemi në kushtet e pandemisë, e zhvillojmë mbledhjen në kushte elektronike, vëmë në dispozicion të gjithë mundësitë dhe teknologjitë që kemi, janë disa komisione që punojnë dhe në këtë mbledhje janë 4 çështje që do të shqyrtohen dhe nuk jeni vetëm ju që do të flisni.

Fjala për ju.

Bledar Dervishaj – Dakord!

Referuar shtimit të kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit me 13 vjet të tjerë shtesë, më gjatë se gjysma e afatit të vetë kontratës edhe të shtuar, e bën që praktikisht të jemi para një koncesioni të ri që, siç e shpjegoi kolegja Treska, është realizuar pa garë, pa ndjekur asnjë procedurë ligjore konkurrimi dhe pa një studim të mirëfilltë fizibiliteti që duhej të niste me vlerësimin e ecurisë dhe dobishmërisë së kontratës pararendëse, pra të kontratës që është duke u zbatuar; përcaktimin e saktë të llojit, objektit dhe afatit të koncesionit; vlerësimin e rreziqeve të drejtpërdrejta financiare dhe ndikimin në buxhetin e qeverisë qendrore dhe vendore që merr parasysh në veçanti interesin publik, ndikimin në mjedis dhe mbrojtjen e mjedisit apo masat për ruajtjen e përmirësimin e tij; qëndrueshmërinë, përshtatshmërinë financiare të projektit, treguesit e vlerës së parasë; harmonizimin e projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë; rreziqet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta apo edhe realizueshmërinë teknike dhe tregtare.

Relacionin e Këshillit të Ministrave janë shprehur, gjithashtu, se aeroporti është një nga asetet më të rëndësishme strategjike të Republikës së Shqipërisë. Duke qenë një aset i tillë, nuk gjendet asnjë sqarim në relacion për faktet se:

-Cili ka qenë vlerësimi ekonomik i dhënies së këtij koncesioni ekskluziv nga viti 2005, deri në amendimin e parë të kontratës koncesionare, por edhe më pas për sa i përket përfitimit të shoqërisë nga kjo kontratë koncesionare?

- Cili ka qenë përfitimi i shtetit dhe i qytetarëve për shfrytëzimin e këtij aseti me koncesion?

- Pse qeveria nuk ka ndërtuar një plan strategjik për shfrytëzimin e këtij aseti pas

përfundimit të koncesionit në vitin 2027, kur të bëhej një vlerësim i shfrytëzimit të tij dhe të planifikoheshin përmirësimet e domosdoshme dhe të nevojshme për rihënien me koncesion, me qëllim arritjen e një përfitimi sa më të lartë në favor të interesit publik, në drejtim të zhvillimit të transporti ajror dhe të tarifave të ofruara?

Pra, rezulton që, sipas atyre që janë shkruar në praktikën parlamentare, ecuria dhe të ardhurat që gjeneron ky aeroport janë rritur në mënyrë të ndjeshme, dhe duhet ta kishtin vendosur qeverinë shqiptare në pozita shumë herë më të shëndosha negociuse, si për termat ekonomiko-financiare, edhe për investimet për përmirësimin e infrastrukturës.

Siç përcaktohet në marrëveshjen ndryshuese, investimet do të kapin vlerën 99 milionë euro, por 100% me fonde të shoqërisë koncesionare. Megjithatë, ajo që bie në sy, referuar listës së përcaktuar për investime, është mungesa e një raporti të detajuar, që të justifikojë përcaktimin e vlerës në euro për secilin zë investues. Për ilustrim, në këtë shtojcë përcaktohet si investim: zgjatimi i pistës - 4 milionë e 450 mijë euro; zgjerimi i terminalit - 23 milionë euro; reabilitimi strukturor - 14 milionë euro. Asnjë prej këtyre zërave nuk shoqërohet me të dhëna konkrete matëse të ndërhyrjeve apo të investimit, referuar pyetjeve sa dhe kur do të përfundojë zgjatimi i pistës, sa dhe kur do të përfundojë zgjerimi i terminalit, sa dhe kur do të përfundojë shtimi i trafikut, dhe aq më pak e dhëna për mënyrën se si është përlogaritur kostoja e këtyre ndërhyrjeve.

Niveli i investimeve, sipas argumentimit në relacion, ka qenë një ndër arsyt kryesore nxitëse të qeverisë, që ka justifikuar dhënien e dakordësisë për ndryshime në marrëveshjen koncesionare. Mungesa e transparencës dhe mekanizmave realë matës për projektet e një investimi, që pretendohet të realizohet, vendos në pikëpyetje qëllimet, që kanë çuar në lidhjen e kontratës, si dhe mënyrën se si do të mbikëqyret koncesioni nga OSHA.

Siç thuhet në relacionin e raportit të Komisionit të Ekonomisë dhe siç evidentohet edhe nga ekstrakti i shoqërisë “Tirana Internacional Airport” në QKB, në dhjetor të vitit 2020 koncesioni iu shit shoqërisë “Kastrati Group”, me një vlerë prej 70,1 milionë euro. Kjo shoqëri bleu 100% aksionet e kompanisë koncesionare. Shoqëria në fjalë është grupi më i madh me aktivitet kryesor tregtimin me pakicë të karburanteve, por vitet e fundit është diversifikuar kryesisht në sigurime, në sektorin e ndërtimit, në turizëm dhe tashmë ka hyrë në transportin ajror përmes aeroportit.

Neni 32 i ligjit nr. 125/2013 parashikon: “Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncensionit mund të transferohet te një person i tretë, i cili përmbush kushtet e përshtatshmërisë të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht”.

Në pikën 4 të neni 32 thuhet: “Për të gjitha transferimet e planifikuara të kontratës, autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria përgjegjëse për Financat, e cila vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2 të neni 10”.

Ndërkohë, në relacionin dhe në raportet e komisioneve, që kanë shqyrtuar nismën, nuk jepen të dhëna nëse është dhënë miratim nga OSHA për ndryshimin e ortakut, që zotëron aksionet e shoqërisë “Tirana Internacional Airport”, me të cilën shteti shqiptar ka lidhur një marrëveshje koncesionare para transferimit të kuotave më 1.12.2020.

A ka kërkuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe a ka dhënë miratim paraprak Ministria e Financave për ndryshimin e kontratës koncesionare në përputhje me kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi?

Si është lejuar transferimi i kuotës së koncesionit?

Për shkak të rëndësisë që paraqet ky koncesion, dhënies së miratimit duhet t’i paraprinte, për më tepër, një konsultim me disa institucione shtetërore, një verifikim thelbësor i thelluar i disa elementeve që lidhen me:

- verifikimin e gjendjes pasurore të shoqërisë përfituese të këtij koncesioni, përfshirë burimin e të ardhurave prej 70,1 milionë euro, shumë e konsiderueshme për t’u disponuar nga një subjekt i vetëm tregtar në realitetin tonë ekonomik, duke marrë në konsideratë edhe faktin që subjekti përfitues, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ka në realizim disa kontrata të tjera koncesionare me shtetin shqiptar, që përfshijnë edhe detyrime të tjera për t’u përmbushur lidhur me investimet, që ka marrë përsipër të kryejë;

- verifikimin e stabilitetit financiar të shoqërisë tregtare, që synonte të blinte aksionet e shoqërisë koncesionare;

Fakti nëse shoqëria është aktualisht direkt apo indirekt, përfituese, mbajtëse e ndonjë të drejte tjetër koncesionare, pronësie, bashkëpronësie, aksionere apo bashkëaksionere në fushën e transportit ajror të ndonjë subjekti, të ndonjë aeroporti tjetër në vend apo pikë infrastrukture tjetër transporti, qoftë detar, rrugor apo hekurudhor, për të shmangur, përmes një vlerësimi të thelluar çdo pozitë dominuese në fushën e transportit, jo vetëm të atij ajror, por edhe rrugor dhe

detar, çdo lloj përqëndrimi në duart e një subjekti të vetëm të pikave strategjike e me rëndësi kombëtare për zhvillimin e vendit, shmangien e përqëndrimit dhe ndikimin në konkurrencën e lirë në fushën e transportit të mallrave, të udhëtarëve, lidhjen direkte apo indirekte të kësaj shoqërie, që mund të kenë ndikim në vendimmarrje apo në mënyrën e menaxhimit të koncesionit, për sa kohë bëhet fjalë për një shërbim strategjik.

Transferimi i kuotave më 1 dhjetor 2020, në cilësinë e ortakut të vetëm, te shoqëria përfituese, nga aktmarrëveshja është bërë në shumën 70,1 milionë euro. Siç rezulton, për këtë aktivitet tregtar të detikuar, që sipas kontratës së koncesionit, në momentin e blerjes së aksioneve, kishin mbetur për operim 6 vjet e 6 muaj, shoqëria përfituese është investuar dhe ka blerë aksionet në shumën 70 milionë euro. Në këto kushte, duke njohur kontekstin aktual, investimet e kryera nga kjo shoqëri, natyrshëm lindin pyetjet, për të cilat Kuvendi duhet të ishte investuar posaçërisht dhe të kishte të dhëna financiare, e jo ta kalonte këtë nismë brenda 4 ditëve.

Pyetjet që duhet të kishin marrë përgjigje në Kuvend janë: a ka pasur kontakte, negociata apo shqyrtime mundësish për zgjatjen e afatit të kontratës së koncesionit edhe me 13 vjet të tjerë para kryerjes së transaksionit me kuotat e shoqërisë “Tirana Internacional Airport? Nëse po, pse nuk kanë avancuar negociatat me aksionerin e huaj të mëparshëm?

A është kryer investimi prej 70,1 milionë eurosh shoqërisë shqiptare, që ka blerë aksionet e shoqërisë koncesionare, me një plan investimi për 6 vjet të mbetura, sepse në dhjetor ai afat kishte ngelur, apo ka pasur një plan investimi për 19 vjet me një garanci paraprake të qeverisë për zgjatjen e afatit të koncesionit?

Këto pyetje bëhen edhe për faktin se, nga momenti i blerjes së kuotave të shoqërisë koncesionare nga shoqëria përfituese, në dhjetor të viti 2020 deri në miratimin e ndryshimeve të kontratës koncesionare, që përfshin fazën e paraqitjes së kërkesës, vlerësimin, marrjen e mendimit të institucioneve, kanë kaluar më pak se 2 muaj. Kjo bën të krijohet ideja, pse jo edhe bindja, që shoqëria e re përfituese, që ka blerë aksionet e shoqërisë “Tirana Internacional Airport”, e ka pasur paraprakisht të qartë, ndoshta të sigurt, natyrën dhe kohëzgjatjen e investimit që do të kryente para se të ndërmerre hapin për investimin në blerjen e aksioneve prej 70,1 milionë eurosh, ndërkohë që, sipas planit të biznesit të propozuar, do të investohet në 20 vjetët e tjerë operim, edhe 100 milionë euro.

Risku i shtuar për një infrastrukturë të rëndësishme, e cila lidhet drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare, siç është Aeroporti i Rinasit, vjen edhe nga parashikimi i pikës 2/15 të

aktmarrëveshjes ndryshuese, që parashikon shprehimisht detyrimet e koncesionarit për të financuar projektin. Palët bien dakord që shoqëria, me qëllim përmbushjen e investimeve, cilësinë dhe afatin e parashikuar në shtojcën 23/1, duhet të marrë masat e nevojshme për të financuar projektin me kredi në institucionet vendase dhe/ose të huaja financiare.

Anastas Angjeli – Ju lutem, përmbylleni!

Bledar Dervishaj – Edhe 1 minutë dhe do ta mbyll.

Ortaku i shoqërisë koncesionare mund të garantojë shlyerjen e kredive, huave të marra, në përputhje me parashikimin si më sipër, duke vendosur barrë për kuotat e shoqërisë koncesionare. Këtë e thotë kontrata e marrëveshjes shtesë.

Ndërkohë që kontrata e koncesionit parashikon mes të tjerash që kontrata koncesionare, shoqëria koncesionare, ka të drejtë të ketë në pronësi ndërtime të reja. Konkretisht neni 6 në pikën 16: vendosja përmes ligjit dhe autorizimit për shoqërinë për marrjen e huave, duke lënë kolateral aksionet e shoqërisë ndërkohë që shoqëria ka titull pronësie mbi ndërtimet e reja, pjesë e pa ndarë e infrastrukturës aeroportuale dhe që përfshin deri terminalin e ri, e vë para një rreziku të shtuar potencial të gjithë funksionimin e këtij shërbimi përkundrejt sigurisë kombëtare, kjo sepse përmes këtij parashikimi tashmë të miratuar me ligj dhe jo përmes autorizimit (*nuk dëgjohet*)... dëmtohet veprimtaria e transportit ajror përmes të vetmit aeroport ndërkombëtar profesional në Republikën e Shqipërisë në rastin e ndonjë paaftësie paguese të shoqërisë për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin prej huave të marra. Këto parashikime në kontratë, përveç se paraqesin rrezik për operimin normal të aeroportit, që mund të vijnë për shkak të paaftësisë paguese të shoqërisë koncesionare, nga ana tjetër tregojnë që investimi që është marrë përsipër sipas planit të biznesit, do të sigurohet përmes kontratave të kredive bankare, duke vendosur kolateral vetë aksionet e shoqërisë.

Për ta përmbyllur, ky fakt thellon bindjen se OSHA-ja nuk ka kryer asnjë vlerësim të kapaciteteve dhe besueshmërisë financiare të kompanisë propozuese, por ka pranuar apriori propozimin e saj, duke faturuar të gjithë riskun dhe asetet e koncesionit dhe aksionet e shoqërisë Tirana *International Airport* shpk. Arsyetimi i Presidentit vijon dhe është më i gjatë, ndaj unë nuk po zgjatem më se detajet kryesore i dha zonja Treska, por Presidenti në përfundim të arsytimit të tij i ka kërkuar dhe i kërkon Kuvendit të Shqipërisë rishikimin e ligjit në tërësi dhe kthimin mbrapsht në Këshillin e Ministrave të kësaj nisme ligjore, e cila bie në kundërshtim me interesin publik, me interesin e shtetaseve dhe nuk garanton qëndrueshmëri në realizmin e saj.

Unë me kaq e mbyll fjalën time, zoti kryetar, dhe më falni që u zgjata, por është material i gjatë dhe i detajuar!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Si relator do të thosha shkurtimisht disa nga çështjet që u ngritën pastaj pa dyshim që ministrja e Transportit dhe Energjisë dhe zëvendësministrja e Financave luten që të jenë koncize dhe t'u japin përgjigje vetëm argumenteve kryesore, që ka përdorur Presidenca për kthimin e projektligjit. Doja të theksoja që Komisioni i Ekonomisë dhe Financave e shqyrton këtë dekret në cilësinë e komisionit përgjegjës, ashtu sikurse diskutoi edhe projektin në fazën e parë, ku gjithashtu kishim edhe mendimin e Komisionit të Ligjeve. Ky diskutim i sotshëm zhvillohet në përputhje me rregullat e neneve 32, 38 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit. Mbështetur në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit, dekreti për kthimin e ligjit për shqyrtim është bërë pjesë e rendit të ditës, konform të gjitha procedurave në mbledhjen e parë që është zhvilluar për këtë qëllim. Komisioni e shqyrton dekretin vetëm për çështjet, që janë paraqitur në arsyetim për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

Natyrisht që për të pasur një mendim profesional, ne, siç e theksova që në krye të fjalës, për këtë dekret, i jemi drejtuar dy ministrive që janë marrë me sistemin në fjalë.

Doja të ndalesha vetëm te fakti që ne kemi paraqitur si komision një relacion të plotë për të gjitha çështjet e ngritura në dekretin e Presidentit dhe kemi argumentuar të gjitha qëndrimet tona, por doja të ndalesha shkurtimisht edhe në 3-4 çështje të vogla, por të rëndësishme, që ngrihen në argumentet e Presidentit.

Argumenti i parë, i cili mori gati gjysmë ore fjalim nga të dy përfaqësuesit e Presidencës, ka të bëjë me procedurën e shqyrtimit në Kuvendin e Shqipërisë të këtij projektligji, duke dhënë disa arsye se janë shkelur ligjet dhe rregulloret. Dua të bëj më dije përfaqësuesit e Presidencës, opinionin publik dhe ju, të nderuar kolegë të komisionit, se Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave, si dhe çdo komision tjetër, i shqyrton aktet ligjore, që vijnë në Kuvend, në përputhje me vendimet që merr Konferenca e Kryetarëve të Kuvendit dhe natyrisht edhe në përputhje me kalendarin e punimeve të Kuvendit. Në lidhje me aktin ligjor të paraqitur, që po shqyrtojmë, kjo procedurë e zbatimit nga ana e Komisionit të Ekonomisë ka qenë shumë korrekte. Është bërë një mbledhje e Konferencës së Kryetarëve dhe ka marrë miratimin me vendim nr. 2, datë 27.01.2021, ku ka përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit, dhe pa dyshim edhe të komisionit, edhe projektin e fjalë "Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së

koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare Tirana *International Airport* shpk. për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza, Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.12.2004” të ndryshuar””. Gjithashtu dua t’ju bëj me dije se ky vendim i marrë për miratimin e kalendarit të punimeve të Kuvendit është bërë me mirëkuptimin e të gjithë përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të kryetarëve, që ishin pjesëtarë në këtë mbledhje. Kështu që Komisioni i Ekonomisë, nga kjo pikëpamje, nuk ka shkelur asnjë procedurë, por ka zbatuar vendimin e marrë nga Konferenca e Kryetarëve me përpikëri në të gjithë procesin.

Sa i përket çështjes së dytë, që doja të shqyrtoja dhe që është shumica e pjesës tjetër të argumenteve në fjalën e të dy përfaqësuesve, por edhe në materialin e depozituar, ka të bëjë me çështjen e shtyrjes së afatit, mënyrës së procesit dhe të procedurës, që është zhvilluar për shtyrjen e afatit të kontratës nga OSHA-ja nga ministria, nga grupi i punës, nga vendimi i qeverisë deri në miratimin e projektligjit.

Komisioni i Ekonomisë bazuar edhe në relacionin e Komisionit të Ligjeve, që ka parë kushtetutshmërinë dhe përputhjen me legjislacionin në fuqi, e ka shqyrtuar këtë çështje me shumë kujdes dhe ka konstatuar se zgjatja e afatit bëhet në rastet kur nuk parashikohet në kontratën bazë, ndaj duhet patjetër që të bëhet në mënyrë të veçantë dhe sipas një procedure të veçantë, por në kontratën bazë të firmosur në vitin 2004 klauzola e mosparashikimit nuk ekziston, përkundrazi, ekziston klauzola e parashikimit në kontratën bazë dhe, kur është e parashikuar në kontratën bazë, atëherë kjo është një çështje që i takon zgjatjes së afatit, sipas procedurës që është zhvilluar deri tani.

Çështja e tretë. Gjatë gjithë kohës, në të gjitha argumentet e përmendura, ashtu si dhe në herët e tjera, përdoret gjithnjë argumenti se është prekur interesi publik dhe qëndrueshmëria financiare; është shkelur barazia para ligjit, konkurrenca e lirë e kështu me radhë, dhe këto janë thënë në disa diskutime që kemi bërë për dekretet e kthyer nga Presidenti i Republikës.

Presidenti i Republikës është në të drejtën e vet për të kthyer, por duhet t’u referohet neneve kushtetuese që janë shkelur. Në parlament ne nuk u nënshtrohemi diskutimeve parimore, në kuptimin që diskutohet vetëm në parim. Në qoftë se ka shkelje të neneve konkrete, ne duam të na referohen nenet konkrete.

Në rastin konkret, sipas një dokumenti zyrtar, që është raporti i Komisionit të Ligjeve, që na është referuar (po të doni, jua lexoj raportin, vendimin përfundimtar të Komisionit të Ligjeve),

konstatohet se i gjithë akti i paraqitur është në përputhje me Kushtetutën.

Në relacionin e Komisionit të Ligjeve thuhet: "Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut vlerësoi: në aspektin ligjor projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi; në aspektin procedural projektligji është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit" dhe, në këtë mënyrë, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, edhe pse është komision përgjegjës, e shqyrton atë në aspektet e çështjeve ekonomike dhe financiare, pa dyshim, edhe në ato ligjore, por bazohet në opinionin e Komisionit të Ligjeve.

Së katërti, këtu u fol për çështje nga pikëpamja ekonomike, të rrezikut, riskut, stabilitetit financiar, të përfitimeve apo humbjeve të buxhetit të shtetit. Jam i sigurt që zëvendësministrja e Financave, që ka qenë edhe kryetare e grupit të punës që ka negociuar marrëveshjen, do t'i përgjigjet kësaj çështjeje.

Kisha një vërejtje miqësore për përfaqësuesit e Presidencës, për përdorimin e shprehjes "për korrupsion legjislativ". Mendoj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm në përdorimin e këtij termi, i cili nuk është kushtetues, sepse duhet të jemi të besueshëm para opinionit publik. Unë nuk marr përsipër të flas në emër të kujtdo në këtë komision, por në emër të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dua t'ju siguroj se ky komision ka respektuar me korrektësi të gjitha përcaktimet në Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit, procedura këto që besoj se nuk janë të kontestueshme, aq më tepër që edhe në bazë të nenit 31 të ligjit "Për prokurimet publike" zyrtarët publikë dhe antëtarët e familjeve të tyre nuk mund të marrin pjesë në tenderë të prokuruar nga sektorët përkatës; as anëtarët e komisionit nuk kanë lidhje dhe interesa personale në këtë çështje; të gjithë kanë marrë pjesë në mbledhje dhe askush nuk ka deklaruar mospjesëmarrjen për shkak të ndonjë konflikti interesi.

Kështu që, me gjithë respektin e madh për vërejtjet e bëra apo për përfaqësuesit, dua të theksoj edhe një herë që standardet që kanë respektuar Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Ekonomisë, janë standarde të një korrektësie të plotë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për shqyrtimin e projektligjeve. Prandaj, me keqardhje, e them edhe një herë që është shumë e lehtë të përdorësh etiketime jokushtetuese ndaj organeve kushtetuese, siç janë organi i Kuvendit dhe komisionet e tij.

Në fund doja të theksoja që diskutimin e këtij projekti tashmë do ta vazhdojmë duke ia dhënë fjalën ministres Balluku, për të cilën kam lutjen që edhe ajo të jetë në vijim të diskutimeve

që po bëjmë kundrejt argumenteve që ka përdorur Presidenca dhe sidomos të atyre që lidhen me shkeljen kushtetuese që presupozohet nga ana e saj.

Faleminderit!

Fjala është për ministren Balluku.

Belinda Balluku - Mirëdita!

Uroj të jeni të gjithë mirë me shëndet!

E kam dëgjuar me shumë vëmendje të gjithë relacionin e lexuar nga përfaqësuesit e Presidencës.

Në radhë të parë, dua të them që, në respekt të plotë të institucionit të Presidentit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i është përgjigjur çdo pyetjeje me shumë rigorozitet dhe pa devijuar për asnjë moment. Kështu që unë nuk e di se cilës pjesë i referohet përfaqësuesi i Presidencës, që nuk ka marrë përgjigje nga ministrinë. Unë kam përpara shkresën e përgjigjes dhe, për më tepër, kemi bërë të pamundurën për të qenë brenda afateve shumë të ngushta që na janë kërkuar nga Presidenca për dorëzimin e informacionit. Megjithatë, ne jemi në dispozicion dhe nuk ka asnjë lloj problematike.

Tani, para se të vijoj, kryetar, dua që përfaqësuesi i Presidencës apo zonja, e cila bëri prezantimin e relacionit, të na saktësojnë dy fakte shumë të rëndësishme.

E para, për të cilën dua të kem një përgjigje dhe më pas të vazhdoj argumentimin tim është: kjo është një marrëveshje ndërkombëtare apo një kontratë koncesionare?

Bledar Dervishaj - Po, këtë saktësim e kemi kërkuar ne, zonja Ministre, nga ju.

Belinda Balluku - I nderuar zoti Dervishaj, në këndvështrimin tonë dhe të ligjit, sigurisht, kjo është një kontratë koncesionare, ashtu sikurse ju i jeni referuar gjatë gjithë relacionit, përveç një momenti, kur zonja, kolegja juaj që ka bërë pjesën e prezantimit, e ka referuar këtë akt si marrëveshje ndërkombëtare. Ky akt është kontratë koncesionare. Ne jemi në regjistrim, kështu që mund t'i ktheheni dhe mund ta dëgjoni se çfarë ka të thënë zonja.

Bledar Dervishaj – Jo, unë jam i qartë shumë, për çfarë tha kolegja ime, se e kemi shkruar me këto dy duar atë arsyetim dekreti. Unë e di shumë mirë se çfarë tha kolegja, por është pyetje...

Belinda Balluku – Atëherë, është kontratë koncesionare, zoti Dervishaj?

Bledar Dervishaj – Po, për ratifikim kontratë koncesionare, ne po flasim te baza ligjore 121, që keni përdorur ju i referohet...

Belinda Balluku – Atëherë, vetëm këtë pyetje kam. Pra, edhe ju e konsideroni kontratë koncesionare, kështu që...

Bledar Dervishaj – Ti po përgjigjesh për mua? Ju po përgjigjeni për mua?

Belinda Balluku – Kryetar, unë mund të vazhdoj, në qoftë se është kontratë koncesionare.

Anastas Angjeli – Ju lutem, Bledar, pa debat. Bëtë një pyetje, u dha një përgjigje.

Bledar Dervishi – Bëri një pyetje.

Anastas Angjeli – Po. Ajo kishte interpretimin e saj, ju kishit interpretimit tuaj.

Bledar Dervishi – Unë nuk dhashë interpretim.

Belinda Balluku - Zoti Dervishaj, kam edhe një pyetje të dytë. Atëherë, negociata kryhet me aksionerin apo me shoqërinë koncesionare?

Bledar Dervishi – Në ç’kuptim?

Belinda Balluku – Pra, një negociatë e një kontrate koncesionare, kryhet me aksionerin, sepse ju i referoheni ndryshmit të aksionerit apo kryhet me shoqërinë aksionare, sipas jush?

Bledar Dervishaj - Shumë e bukur pyetja, më pëlqen vërtet. Bëhet me kontratën koncesionare, në momentin kur ka ndryshuar nga aksioneri. Këtë kemi thënë ne në dekret.

Belinda Balluku – Ju falënderoj, zoti Dervishaj!

Kryetar, mund të vazhdoj?

Bledar Dervishaj – Jo, mos ma ndërprit, se nuk e kam mbaruar përgjigjen. Në qoftë se do t’i referohemi një marrëveshjeje ndërkombëtare, kjo kontratë duhet të shkojë në Gjykatën Kushtetuese, sipas Kushtetutës, përpara se të ratifikohet dhe që se keni përdorur si bazë ligjore. Kështu i bie? Kjo ishte pyetja në arsyetim të dekretit, nëse e keni lexuar arsyetimin e dekretit.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Fjala për zonjën Balluku.

Belinda Balluku - Atëherë, unë mund të vazhdoj, sepse këtu kemi një kontratë koncesionare dhe jo një marrëveshje ndërkombëtare dhe këtu negociata, sipas ligjit, për kontrata koncesionare bëhet me shoqërinë koncesionare dhe jo me aksionerin, sepse më pas do të na lindte pyetja: nëse kemi pesë aksionerë, kë thërrasim në tryezë? Kështu që, ne kemi bërë gjithçka në përputhje me ligjin. Shkoj te pikat, sipas atyre që mund t’i përgjigjem nga krahu i Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Energjisë dhe sigurisht, zonja Vjero, si kryetare e OSHA-së, do të japë shpjegimet e saja.

Është folur që kemi shkelur të gjitha parimet për sa i përket Kodit Zgjedhor. Më vjen keq, ekziston një shkresë, pra kemi një marrëdhënie shkresore me KQZ-në, e cila na është përgjigjur se jemi në përputhshmëri të plotë të këtij akti, ndaj dhe ne kemi vazhduar procesin. Nuk e kemi bërë me kokën tonë dhe dua t'ju informoj.

Është folur këtu që nuk ka një plan strategjik për sa u përket këtyre zhvillimeve në aviacion dhe kjo nuk është e vërtetë, pasi nëse u referoheni të gjitha mediave dhe të gjithë publikimeve zyrtare që ne kemi bërë, në shtator të vitit 2019, nga Vlora kemi shpallur planin kombëtar për aviacionin civil, që është një plan strategjik dhe ka në bazën e tij krijimin e kushteve për shërbime më cilësore në aviacionin civil shqiptar, si dhe uljen e çmimeve, që është synimi kryesor. Që të dyja këto, janë akomoduar përmes këtij rinegoziimi të kontratës së koncesionit të aeroportit ndërkombëtar të Rinasit.

Gjithashtu, është folur për një koncesion të ri, ndërkohë që unë jam e shumë e sigurt që edhe, ju vetë, jeni të qartë që ky nuk është një koncesion i ri, pasi nuk ka ndryshuar asnjë parim thelbësor i kësaj kontrate koncesionare. Është një negociatë e nisur në janar të vitit 2020 me shoqërinë koncesionare, siç ramë edhe parimisht dakord që negociatat bëhen me shoqërinë koncesionare dhe nëse ndërkohë ka transferim të aksioneve, kjo nuk afekton as kohën e negociatave dhe nuk i nis negociatat nga e para, pasi negociatat kanë vazhduar mbi bazën e negociimeve të nisura në janar të vitit 2020 me të njëjtën shoqëri koncesionare.

Diçka tjetër që unë dua të shtoj nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, është për shërbimet e tokës. Ju referoheni në relacion se çfarë janë shërbimet e tokës, nëse përfshijmë këtë shërbim apo atë shërbim. Shërbimet e tokës e kanë një përkufizim në terma ndërkombëtarë në bazë të rregullores së IATAO-s. Pra, shërbimet e tokës nuk i vendos as Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe as Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mjafton t'u referohemi rregulloreve dhe proceduarve të IATAO-s dhe do të shikoni se çfarë janë shërbime të tokës.

Për sa i përket investimit prej 99,3 milionë eurosh, ka një aneks bashkangjitur me të gjitha detajet për këto investime, të cilat kanë qenë një nga pjesët kryesore të negociatës tonë dhe që ne të kërkojmë sot, që në një koncesion shumë të rëndësishëm të investohen rreth 100 milionë euro, duke përmblusur këtu kushtet e sigurisë, që besoj kanë qenë një shqetësim, si për qeverinë, ashtu edhe për Presidentin, pasi Presidenti është shprehur disa herë, me shumë të drejtë, për komprometimin e sigurisë në Aeroportin e Rinasit, nëse këto investime do të shërbejnë në rritjen

e kapaciteteve të përpunimit, qofshin këto për shtimin e numrit të avionëve dhe qofshin këto për rritjen e konkurrencës brenda kompanive të aviacionit, sigurisht kjo do të sillte uljen e çmimeve.

Pra, ky investim do të derivojë në uljen e çmimeve dhe rritje të cilësisë, duke përmbushur kështu kriteret e strategjisë tonë kombëtare për zhvillimin e aviacionit në vend. Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk janë identifikuar të tjera çështje. Është thënë që është shkelur MSA-ja, pavarësisht se kjo ndoshta nuk ka të bëjë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Energjisë, por ndoshta si përfaqësuese e Këshillit të Ministrave, këtu dua shumë të kuptoj ku është shkelur MSA-ja, pasi këtu, siç e thamë, nuk ka pasur vend për të bërë një koncesion të ri. Pra, këtu është negociuar koncesioni ekzistues duke rritur volumet e investimit duke rritur kërkesat dhe duke shtuar penalitetet, penalitete të shkruara, të përkthyer në akte financiare, të cilat koncesionari do t'ju përgjigjet, sipas neneve të kësaj kontrate.

Pra, ku është shkelur MSA-ja? Sepse këtu nuk ka munguar asnjë proces. Negociata është bërë për më shumë s enjë vit. Negociata ka qenë e hapur dhe janë mbajtur, hap pas hapi, të gjitha të dhënat nga çdo takim që është bërë. Ka pasur një transparencë për sa i përket të gjithë adresimit edhe në mënyrë elektronike, të shqetësimeve të të dyja palëve.

Kështu që kur themi se është shkelur MSA-ja, vura re që edhe vetë relatorët e thanë thjesht si fjalë, pa e detajuar dhe pa dhënë konkretisht se ku është shkelur MSA-ja. Me thënë të drejtën, kjo është fjalë e madhe dhe do të ishte mirë, në rast se ju e besoni, që ta faktoni këtë gjë, zoti Dervishaj.

Çështje të tjera, për të thënë të drejtën, nga ministria jonë besoj që nuk ka për t'u prekur. Do të thosha edhe një herë që ne kemi qenë të gatshëm dhe me respekt të plotë ndaj institucionit të Presidentit. Jemi përgjigjur në kohë dhe për çdo pyetjeje, siç jemi gjithmonë të gatshëm për ta informuar këtë institucion shumë të nderuar.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Balluku!

Fjalën e ka zonja Vjero.

Vasilika Vjero – Faleminderit, zoti kryetar!

Besoj se dëgjohem.

Anastas Angjeli – Po, po.

Vasilika Vjero – Në fakt, edhe unë po përqendrohem te disa pika të përgjigjes dhe të çështjeve, të cilat u trajtuan sot nga përfaqësuesit e Presidencës.

Unë dua të theksoj që edhe Ministria e Financave ka dërguar zyrtarisht pranë Komisionit të Ekonomisë të gjitha përgjigjet e argumentuara dhe të shtjelluara, të cilat lidhen edhe me të gjitha pikat dhe elementet që trajton dekreti i Presidentit të Republikës.

Po përqendrohemi tek ato çka janë më kryesoret që lidhen me përgjegjësinë e Ministrisë së Financave.

Lidhur me pretendimin e parë, që lidhet me mënyrën se si është kryer negocimi dhe miratimi i shkresës së kontratës, ku pretendohet apo ku argumentohet se është lidhur me një shpejtësi shumë të madhe, unë do të doja të sqaroja që të gjitha kërkesat dhe të ritheksoj që kërkesat për negocim, në fakt, të iniciuara nga organi shtetëror i autorizuar, Ministria e Financave dhe ajo e Energjetikës, kanë filluar që gjatë vitit të kaluar, pra fillimit të vitit 2020 dhe në përbërje të grupit ka qenë zëvendësministri Haxhi më tej edhe disa përfaqësues të tjerë, të cilët janë larguar. Kjo për të thënë se është një procedurë e nisur kohë më përpara.

Fatkeqësisht, këto negociata u ndërprejnë edhe, si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia, për muaj rresht ne nuk arritëm dot që të mbledheshim, as edhe virtualisht. Më tej, në muajin dhjetor, është prezantuar kërkesa për vijimin e këtyre negociatave dhe, sigurisht, ka filluar e gjithë puna dhe mobilizimi i grupit negociator për ta trajtuar këtë kërkesë.

Pas miratimit të raportit nga OSHA-ja, është proceduar edhe me draftimin e marrëveshjes ndryshuese, e cila, në mbështetje edhe të pikës 3.2 të neneve 3 dhe 33 të marrëveshjes koncesionare, më tej është noteruar përpara një noteri publik.

Dua të them se ky ka qenë një proces i gjatë diskutimesh, debatesh dhe jo vetëm midis nesh, por edhe me përfaqësuesit e kompanisë koncesionare për të ardhur me një propozim, i cili ishte sa më i pranueshëm dhe kryesisht sa më i pranueshëm për interesat e shtetit shqiptar.

E gjithë kjo procedurë, pra që nga momenti i ngritjes së grupit të punës deri në finalizimin e raportit të negociatave, është ndjekur dhe është asistuar nga institucioni i Avokaturës së Shtetit. Ky institucion, në fakt, ka qenë pjesë e grupit të punës dhe e ka këshilluar grupin gjatë gjithë periudhës së negocimit deri në përfundimin dhe finalizimin e kontratës.

Pas miratimit të këtij raporti, edhe nga titullarët e OSHA-së, draftmarrëveshja i është dërguar përsëri për miratim Avokaturës së Shtetit, i është dërguar Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë në mënyrë që ata të shpreheshin nëse këto ndryshime të kontratës janë në përputhje me legjislacionin.

Përgjigjja që kanë dhënë Ministria e Financave, njëkohësisht, edhe Avokatura e Shtetit ka qenë e gjitha pozitive. Avokatura e Shtetit, e cila ka qenë edhe pjesë e grupit negociator, njëkohësisht, edhe strukturat përkatëse të ministrisë së Financave e kanë vlerësuar këtë ndryshim kontrate, duke e parë qoftë nga implikimet fiskale që kjo kontratë mund të prezantonte për shpenzimet buxhetore, qoftë për deficitin buxhetor apo për qëndrueshmërinë e borxhit publik apo edhe për detyrime kontingjente eventuale. Mund të themi se Ministria e Financave i ka trajtuar të gjitha dhe ka konstatuar se ky ndryshim kontrate nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit, pasi nuk është me mbështetje financiare as direkte apo indirekte.

Lidhur me përbalueshmërinë e projektit, konstatohet se, si rrjedhojë e këtij ndryshimi të marrëveshjes, synohet kryerja e investimeve shtesë në aeroport për rritjen e kategorisë dhe akomodimin e një trafiku më të madh pasagjerësh, investime të cilat do të kryhen tërësisht me financimin e shoqërisë koncesionare, në këtë mënyrë nuk e impaktojnë përbalueshmërinë e tij.

Lidhur me qëndrueshmërinë e projektit në studimin ekonomik dhe financiar që është përgatitur nga shoqëria koncesionare dhe është vlerësuar nga grupi negociator, është argumentuar se ky është një projekt i qëndrueshëm dhe se nuk kërkohet asnjëllëj mbështetjeje financiare për implementimin e objektit të këtij ndryshimi, pra të ndryshimit të marrëveshjes.

Lidhur me analizën e risqeve, konstatohet se një pjesë e madhe e risqeve janë marrë përsipër nga partneri privat, ku ndër më kryesori është risku i kërkesës që impakton zakonisht projektet e kësaj fushe, për të cilat nga shteti asnjëherë nuk kërkohet asnjëllëj garancie. Por edhe në lidhje me risqet që janë marrë përsipër ose janë ndarë me partnerin publik, referuar parashikimeve të analizës së risqeve, përsëri nuk është konstatuar. Pra, nuk konstatohet që buxheti i shtetit të mund të afektohet.

Për këtë dhe shumë çështje të tjera, të cilat janë trajtuar në shkresën e Presidentit, sigurisht që është dhënë një përgjigje shteruese edhe nga ana e Ministrisë së Financave.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Vjero!

Ka njeri ndonjë çështje për të pyetur, për të diskutuar, apo të kalojmë në votim? Nuk ka.

Atëherë, përgatitemi për votim. Ju lutem, të aksesohen të gjithë për mbledhjen, të hapin kamerat, sepse do të përgatitemi për votim!

Edhe një herë, verifikoni pak pjesëmarrjen.

Edhe një herë, ju lutem, aksesoni kamerat, se fillon procesi i votimit. Pjesëmarrësit të aksesojnë.

Sipas legjislacionit në fuqi dekreti votohet vetëm një herë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë të pranishmit janë për rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës.

Faleminderit përfaqësuesve të Presidencës!

Faleminderit, zonja Ministre dhe stafit tuaj për pjesëmarrjen në këtë diskutim dhe argumentet e paraqitura!

Faleminderit, zonja Vjero!

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.3.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Eljo Hysko, Vullnet Sinaj, Reme Lala

Mungojnë:

Artur Roshi, Suzana Topi.

Të ftuar

Besart Kadia - Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Joniada Barjaba – Drejtore e Integritetit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve

Agron Tare - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Inida Methoxha – Drejtoreshë e Komanduar e Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Bujqësisë

Lauresha Grezda - Drejtore e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Anastas Angjeli - Vazhdojmë me çështjen e tretë të rendit të ditës, shqyrtimin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”.

Për të prezantuar projektligjin, në cilësinë e përfaqësuesit të qeverisë kemi sot në mbledhje zotin Besard Kadia, zëvendësministër dhe zonjën Joniada Barjaba, drejtore e Integritit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve; nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme kemi prezent zotin Agron Tare, zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme dhe zonjën Inida Methoxha, drejtoreshë e Komanduar e Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve; nga Ministria e Bujqësisë kemi prezente zonjën Ermira Gjeçi, zëvendësministre, si dhe zonjën Lauresha Grezda, drejtore e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Relatore për këtë projektligj është zonja Senida Mesi.

Nga përfaqësuesit e qeverisë fjala është për përfaqësuesin e Ministrisë së Financave. Zoti Besart, kush do të flasë? Apo do të flasë përfaqësuesi i ndonjë ministrie tjetër? Si e keni koordinuar veprimtarinë?

Besart Kadia – Përshëndetje, kryetar!

Të dyja ministritë do të shprehen, por, nëse dëshiron, mund ta fillojë Ministria e Jashtme e para.

Anastas Angjeli – Dakord. Po, zoti Tare!

Agron Tare – Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të gjithë deputetëve!

Ky projektligj ka si qëllim ratifikimin nga Kuvendi të marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Është miratuar në parim me vendimin nr.1036, datë 16.12.2020 nga Këshilli i Ministrave dhe firmosur nga palët në datë 5.2.2021.

Siç besoj se jemi të gjithë në dijeni, Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit ndërmjet komuniteteve europiane dhe shteteve anëtare të tyre nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, firmosur në Luksemburg në 12 qershor të vitit 2006, ka pushuar së ekzistuari për

Britaninë e Madhe për shkak të daljes së saj nga Bashkimi Europian. Për të adresuar këtë situatë specifike është nënshkruar kjo marrëveshje. Për sa i përket Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme ne e vlerësojmë Britaninë e Madhe si një partner kyç për politikën e Jashtme dhe pse jo të jetë edhe për ekonomi.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Kush tjetër nga përfaqësuesit e qeverisë e do fjalën, Ministria e Financave apo Ministria e Bujqësisë?

Besard Kadia – Zoti kryetar, me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, nga këndvështrimi ekonomik, mallrat me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga Shqipëria do të përfitojnë trajtim tarifor preferencial reciprok, të njëjtë me atë që kanë përfituar kur Mbretëria e Bashkuar ishte pjesë e komunitetit europian dhe palë e Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit.

Marrëveshja në fjalë synon sigurimin e vijimit të bashkëpunimit ekonomik dhe vazhdimin e tregtisë midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar me të njëjtat kushte preferenciale dhe pas daljes së saj nga BE-ja. Shkëmbimet tregtare me Mbretërinë e Bashkuar kanë pasur rritje vitet e fundit, por, gjithsesi, është një potencial i pashfrytëzuar dhe kjo marrëveshje synon pikërisht që të shfrytëzojë këtë potencial shkëmbimesh tregtar midis dy shteteve duke mbajtur këto tarifa preferenciale reciproke.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Kadia!

Ministra e Bujqësisë ka diçka për të shtuar?

Ermira Gjeçi – Ministria e Bujqësisë në këtë marrëveshje ka tri çështje, të cilat preken, janë produktet bujqësore dhe ato të peshkut. Është bërë rivlerësimi i kuotave tarifore që Shqipëria ka me Bashkimin Europian, sipas Marrëveshjes së Stabilizim - ...

Anastas Angjeli – Nuk dëgjoheni, ju lutem!

Ermira Gjeçi – Më dëgjoni tani?

Anastas Angjeli – Po.

Ermira Gjeçi – Për Ministrinë e Bujqësisë ka rishikim të kuotave për produktet bujqësore dhe produktet e peshkut. Është bërë rivlerësimi i tyre sipas marrëveshjes me Bashkimin Europian. Kemi një koeficient për kuotat tarifore 13,6% që ka qenë i panegociueshëm. Ashtu sikurse jeni në dijeni, negociatat kanë vazhduar për një periudhë të gjatë dhe janë udhëhequr nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Produktet me origjinë nga Shqipëria, të cilat përfshijnë kapitullin e shtatë, që janë zarzavatet dhe kapitullin e tetë, që janë

perimet, pranohen për import në Mbretërinë e Bashkuar duke u përjashtuar nga detyrimet tatimore. Për produktet e verës kemi edhe një shtesë prej 681 hektolitër për sa u përket kuotave, e cila do të aplikohet në momentin që shterohet pjesa e parë. Kjo marrëveshje në termat preferencialë ka një afat pesëvjeçar, duke na dhënë mundësinë e rinegocimit të tyre pas 5 vjetëve.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Mesi.

Senida Mesi – Përshëndetje, zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar deputetë dhe të ftuar!

Pak a shumë, të tria ministritë iu referuan fushës së tyre të përgjegjësisë dhe pse një marrëveshje e tillë është e domosdoshme të ratifikohet edhe në Kuvendin e Shqipërisë.

Kjo lidhet pikërisht me daljen e Mbretërisë së Bashkuar nga unioni i Bashkimit Europian dhe si rezultat i krijimit të një vakance apo mungese për të trajtuar mallrat që vijnë nga Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut dhe Republikës së Shqipërisë, në kushtet që jemi sot nuk mundësohet përfitimi i preferencave. Pra, nëse jemi, sikurse në datën 1 janar 2021, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes që Britania e Madhe ka realizuar me vendet e unionit të BE-së, mallrat me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe nga Shqipëria në tregtinë bilaterale do të trajtohen si mallra nga vende të treta, pra pa origjinë preferenciale. Ndaj ratifikimin e kësaj marrëveshjeje për mallrat me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar ne duhet ta kalojmë sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim që të përfitojnë trajtim tarifor preferencial reciprok të njëjtë me atë që kemi pasur kur Mbretëria e Bashkuar ishte pjesë e BE-së dhe palë e MSA-së.

Sa më sipër, prezenca e këtij boshllëku ligjor kërkon ndërhyrjen e menjëhershme për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Edhe zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë iu referua një rritjeje të tregtisë bilaterale midis dy vendeve dhe, sipas të dhënave të INSTAT-it, periudha 2007-2020 rezulton se vlera e importeve në vitin 2019 është rritur me rreth 20%, krahasuar me vitin 2007, ndërsa pesha e importeve është rritur me rreth 34%. Importe kryesore konsistojnë kryesisht në makineri/pajisje, të cilat përbëjnë rreth 50% të totalit të importeve, duke vijuar nga produktet kimike e plastike dhe ushqime e pije në kategorinë e tretë. Ndërsa vlera e eksporteve në vitin 2019 është rritur me 2,3 herë

më shumë në krahasim me vitin 2007. Eksportet kryesore konsistojnë në materialet e ndërtimit dhe metaleve, që përbëjnë rreth 55% të vlerës së eksporteve, duke vijuar nga tekstile dhe këpucë dhe më pas nga ushqime e pije.

Vlen për t'u theksuar ajo që edhe zëvendësministrja e Bujqësisë përmendi, që, përveç standardit dhe marrëveshjes që ne kishim të nënshkruar, është bërë një shtesë preferenciale e përkohshme e dhënë nga Mbretëria e Bashkuar për Shqipërinë për disa produkte bujqësore dhe verëra, të cilat konsistojnë në produktet me origjinë shqiptare të përfshira në kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinar dhe për produktet e verës me kuotë tarifore prej 953 hl sipas marrëveshjes preferenciale, me një kuotë shtesë 681 hl, e cila do të aplikohet pas shterimit të kuotave tarifore të sipërpërmendura.

Si përfundim, dua t'u ofroj mundësinë dhe kërkesën anëtarëve të këtij komisioni, edhe pse komision për dhënie mendimi, ta miratojmë dhe ta ratifikojmë këtë marrëveshje, me qëllim që të nxisim thellimin e marrëveshjeve reciproke dhe tregtinë bilaterale midis dy vendeve, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë, duke synuar jo vetëm të ruajmë të njëjtat marrëdhënie progresive që kemi pasur lidhur me import-eksportin gjatë periudhës 2007-2020, por edhe pas daljes nga Bashkimi Europian të ruhen të njëjtat marrëdhënie dhe intensifikojmë atë.

Faleminderit, zoti kryetar!

Anastas Angjeli- Faleminderit, zonja Mesi!

Unë kam një pyetje: periudha midis kohës së përfundimit të marrëveshjes dhe kohës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje krijon një boshllëk prej dy apo tre muajsh derisa të dekretohet kjo. A ka pasur kjo ndonjë ndikim dhe si janë trajtuar mallrat në qoftë se ka pasur marrëdhënie të eksport-importit për këto tre muaj?

Agron Tare - Në relacionin e relatores, zonjës Mesi, u cilësua, ku trajtohen si vende të treta, pa origjinë preferenciale, kështu që ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është i domosdoshme sa më shpejt.

Anastas Angjeli- Pra duhet të presim dekretin e menjëhershëm që të kemi një ritrajtim të ri të të gjithë kësaj marrëdhënie tregtare.

Kalojmë në votimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut". Kush është dakord? Abstenim nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Abstenim nuk ka. Kundër nuk ka.
Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Abstenim nuk ka. Kundër nuk ka.
Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Abstenim nuk ka. Kundër nuk ka.
Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka Abstenim?
Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”.

Faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë Financave, Ministrisë së Jashtme dhe Ministrisë së Bujqësisë.

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.3.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidatet e vetofruar për pozicionin e anëtarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Rolant Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Eljo Hysko, Vullnet Sinaj, Reme Lala

Mungojnë:

Artur Roshi, Suzana Topi.

Të ftuar:

Kandidatët e vetofruar:

Ervin Koçi

Klement Mersini

Julian Naqellari

Gjergji Duro

Anastas Angjeli - Kalojmë në çështjen e fundit.

Siç jeni vënë në dijeni në mënyrë elektronike, çështja e fundit është seancë dëgjimore me kandidatët e vetofruar për pozicionin e anëtarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Dua t'ju sqaroj se për anëtarë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike Komisioni i Ekonomisë ka të drejtë të propozojë një kandidaturë. Që të jemi të qartë, nuk është me votim në parlament, por është propozim i komisionit, sepse 4 anëtarëve të tjerë, së bashku me anëtarin e propozuar nga Komisioni i ekonomisë 4 vjet më parë u ka mbaruar mandati, prandaj duhet të zëvendësohen. Ministria e Financave është ministria kompetente për të caktuar 4 anëtarët dhe ka bërë shpallje. Meqenëse një nga anëtarët është kompetencë e Komisionit të Ekonomisë dhe 4 kandidatë kanë vetofruar kandidaturën për këtë, që të jemi transparent propozova dhe vendosa të bëjmë këtë seancë dëgjimore me 4 kandidatët dhe pas kësaj seancë unë do t'ju informoj edhe për përzgjedhjen e anëtarëve dhe do të marr mendimin tuaj për t'ia propozuar Ministrisë së Financave, sepse është e drejtë e Komisionit të Ekonomisë.

Kandidatët e vetofruar janë: zoti Ervin Koçi, zoti Klement Mersini, zoti Julian Naqellari dhe zoti Gjergji Duro. Pas dorëzimit të dokumentacionit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë, është përgatitur relacioni përkatës për të gjithë. Me pak fjalë, unë jua thashë procedurën. Kriteret e përcaktuara janë ato kritere që janë edhe për anëtarët e tjerë që ka shpallur Ministria e Financave. Nga verifikimet e 4 kandidaturave rezulton se të 4 kandidaturat i plotësojnë të gjitha kriteret dhe kushtet. Ne do të bëjmë një dëgjese që të jemi transparentë me publikun. Do t'u lutesha kandidatëve që të mos zgjaten më shumë se 5 ose 7 minuta.

Fjalën e ka zoti Ervin Koci.

Është mirë që kandidatët e tjerë të presin, pra të flasin njëri pas tjetrit dhe të mos jenë të pranishëm te secili kandidat.

Fjala për zotin Koci.

Zoti Koci, nuk dëgjoheni.

Ju lutem, hapeni mikrofonin!

Nuk ju dëgjojmë.

Atëherë, kalojmë te kandidatura tjetër, derisa zoti Koci të bëhet gati me pajisjen teknologjike që të komunikojë me ne.

Ftojme zotin Klement Mersini.

A ka mundësi të futet zoti Mersini?

Kjo është mbledhja; nuk ka mbledhje tjetër për ju, kandidatë. Në qoftë se nuk aksesoheni, jeni të skualifikuar. Nuk kemi çfarë të bëjmë.

Zoti Julian?

Julian Naqellari – Përshëndetje!

Anastas Angjeli – Keni 5 deri në 7 minuta për prezantimin tuaj

Julian Naqellari – Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave,

Së pari, uroj të jeni të gjithë mirë me shëndet dhe të gëzoni gjithçka të mirë!

Faleminderit për mundësinë që më dhatë për ta zhvilluar këtë seancë dëgjimore në lidhje me pozicionin e anëtarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike që, sipas kriterëve ligjore, duhet të jetë një jopraktikues, pra një profesionist, i cili ka njohuri në fushën e auditimit ligjor, mund të jetë edhe auditues me licencë, por që nuk e ushtron profesionin të paktën për 3 vjet. Mendoj se i plotësoj të gjitha kriteret....

Anastas Angjeli – Mendimet e tua për këtë? Ato janë kriteret që janë caktuar. Ne i dimë kriteret. Të lutem, çfarë mendon ti për këtë rol që do të marrësh në bord?

Julian Naqellari – Unë jam profesor i auditimit dhe kontabilitetit në Fakultetin e Ekonomisë dhe profesionist kontabël prej më shumë se 15 vjetësh, saktësisht 17 vjet, në kontabilitet dhe auditim ligjor. Aplikoj për të qenë anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike për të dhënë kontributin tim në zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe të audituesit në forcimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së këtij profesioni.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike është anëtar i Forumit Ndërkombëtar të Rregullatorëve të Pavarur të Profesionit dhe mendoj se mund të influencoj për ta arritur objektivin dhe misionin e këtij rregullatori, siç është shërbimi i interesit publik, njëkohësisht, të rrisë mbrojtjen e investitorëve dhe mbështetjen e tyre, duke përmirësuar cilësinë e auditimit të pasqyrave, por jo vetëm, edhe pajtueshmërinë me ligjshmërinë dhe me rregullat në fuqi.

Duke qenë pjesë e këtij bordi, do të doja ta riktheja në rrugën e ligjshmërisë Bordin e Mbikëqyrjes Publike, të influencoj në përmirësimin e marrëdhënieve që ka ky bord me institucionet dhe organizmat e tjerë, të influencoj në krijimin e një organizate të vetme të kontabilistëve të miratuar. Ashtu siç e dimë, sot ka më shumë se një organizatë. Do të doja që të gjithë kontabilistët të ishin pjesë vetëm e një organizate, ndoshta, në një të ardhme të afërt të bashkohej me Institutin e Ekspertëve Kontabël për të rritur cilësinë dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ofrojnë kontabilistët dhe audituesit në këto organizata.

Gjithashtu, dua të influencoj në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke rritur kontrollin e cilësisë së tyre, në mënyrë që këto shërbime të jenë sa më të transparente dhe me interes për publikun. Gjithashtu, dua që edhe kontrolli i cilësisë së shërbimeve të auditimit dhe të kontabilistëve të bëhej mbi bazën e modeleve dhe vlerësimit të riskut. Gjithashtu, përmes ndikimit tim të influencoj në krijimin e një mjedisi sa më konkurrues për shërbimet e kontabilistëve dhe audituesve, të përmirësoj dhe të ndikoj në formalizimin e klimës së të bërit biznes nga ana e këtyre profesionistëve, për shkak të ekzistencës së informalitetit dhe kontrabandës në këtë profesion.

Unë kam një eksperiencë mbi 17-vjeçare në këtë profesion dhe i di cilat janë pikat forta dhe pikat e dobëta të këtij profesioni. Njëkohësisht, jam doktor në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Gjithashtu, kam kryer një sërë shërbimesh pranë prokurorisë dhe SPAK-ut për auditimin dhe ekspertizën në fushën e auditimit dhe pjesën e shërbimeve të lidhura me auditimin. Kështu që prezenca ime në këtë organizatë, që është shumë e rëndësishme si një organizatë e pavarur për të mbikëqyrur profesionin, është për të dhënë kontributin tim me të gjithën ekspertizën, me të gjithë përvojën time kaqvecare për ta çuar më përpara këtë marrëdhënie për t'i ndihmuar dhe për t'i lehtësuar sa më shumë të gjithë anëtarët që janë pjesë e këtyre organizatave dhe për ta çuar përpara profesionin në të ardhmen.

Ky është këndvështrimi dhe vizioni im për pjesëmarrjen.

Anastas Angjeli – Zoti Naqellari, kam dy pyetje për ju.

Çfarë presupozuat me kontrabandën në këtë profesion?

Së dyti, çfarë mendimi keni ju për varësin e kontrollit që duhet t'i bëhet institucionit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike?

Julian Naqellari – Në lidhje me kontrabandën, mund t'ju them me shqetësim se një pjesë e mirë e shërbimeve të kontabilitetit, si përgatitja e pasqyrave financiare, por edhe

shërbime të tjera të kontabilitetit të lidhura me kontabilitetin kryhen nga joprofesionistë, në mënyrë të veçantë nga tatimorë, që në një mënyrë jokonkurruese dëmtojnë jo vetëm cilësinë e shërbimit, por dëmtojnë edhe konkurrencën. Pra, është një lloj evazioni apo kontrabande që dëmton shumë cilësinë e shërbimeve, njëkohësisht, konkurron edhe pjesën e shërbimeve të kryera nga profesionistët.

Anastas Angjeli – E keni mbi bazën e informacioneve, apo e keni një supozim teorik?

Julian Naqellari – Është në bazë të informacioneve, sepse unë kam drejtuar për 4 vjet Institutin e Kontabilistëve dhe kemi pasur shumë shqetësime nga kontabilistët, të cilët janë mjaft të shqetësuar deri tani për këtë ndërhyrje dhe për këtë lloj kontrabande, edhe pse përmes ndërhyrjeve ligjore ne kemi mundur të vëmë në vijë diçka, përsëri ende mbetet shumë për të bërë.

Anastas Angjeli – Për pyetjen tjetër?

Julian Naqellari – Për pyetjen tjetër jam shumë dakord që vetë Bordi i Mbikëqyrjes Publike është institucion i pavarur, por ai nuk mund të abuzojë me këtë pavarësi, prandaj kërkoj që edhe mbi bordin të ketë struktura monitoruese që kontrollojnë dhe mbikëqyrin veprimtarinë e tij, duke përfshirë Kontrollin e Lartë të Shtetit, por edhe institucione të ngarkuara nga parlamenti ose nga qeveria, në mënyrë që edhe bordi të jetë i kontrollueshëm dhe të mos marrë vendime, të cilat mund të jenë në dëm të interesit të organizatave apo në dëm të interesit publik.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Mund të largoheni!

Julian Naqellari – Faleminderit ju!

Ju uroj gjithë të mirat!

Anastas Angjeli – Zoti Ervin, jeni gati?

Ervin Koçi – Po, më dëgjoni?

Ju kërkoj shumë ndjesë për vonesën në lidhjen *online*.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që, në radhë të parë, t'ju uroj të jeni mirë nga kjo situatë pandemie që ka kapur vendin, familjet tuaja.

Më lejoni shkurtimisht të përmend eksperiencën time 22-vjeçare në aktivitetin profesional. Kam punuar për 3 vjet në shoqërinë “*Albpetrol*” në Drejtorinë e Financës. Për 2 vjet

kam qenë drejtor Ekonomik i shoqërisë publike “Armo” sh.a. Për 3 vjet kam drejtuar degën e tatim-taksave për rrethin e Fierit. Kam punuar 4 vjet në sektorin bankar, si drejtues i bankave të nivelit të dytë. Kam qenë për rreth 8 vjet deputet i Kuvendit të Shqipërisë. 3 vjet kam drejtuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare që mbikëqyr tregjet e sigurimeve, tregun e kapitaleve dhe tregun e pensioneve private vullnetare.

Aplikova për anëtarin e bordit, pasi dua të jap kontributin tim për vazhdimin e konsolidimit të Bordit të Mbikëqyrjes Financiare dhe për të luajtur një rol më të rëndësishëm në mbikëqyrjen e audituesve ligjorë, për të pasur një impakt më të mirë në ekonominë e vendit, sidomos në mbrojtje të interesit publik.

Së pari, unë do të përpiqem maksimalisht nëse do të zgjidhem anëtar i bordit, që të rrisim kontrollin e cilësisë në kuadër të përmirësimit të raportit financiar. Janë mbi 3 mijë njësi ekonomike që auditohen nga auditues ligjorë apo dhe nga shoqëri audituesish, të cilët luajnë një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm për sa i përket formalizimit të ekonomisë, por edhe për sa i përket qeverisjes operative. Ne e dimë shumë mirë sot që komuniteti i biznesit në Shqipëri ka probleme me qeverisjen operative, ka probleme shpeshherë edhe me transparencën. Mendoj personalisht se, nëse ne arrijmë të krijojmë një trupë të organizuar audituesish ligjorë me institucione si IEKA, por dhe Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, do të arrijmë të kemi një ekonomi më të formalizuar, më transparente dhe më shumë në interes të publikut.

Së dyti, unë do të fokusohesh në bashkëpunimin që do të kisha me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim-Taksave, si dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Është shumë e rëndësishme, sepse janë këta auditues ligjorë, të cilët auditojnë bilance që shërbejnë për të paguar ose për të derdhur detyrimet që u takojnë sipas ligjeve në fuqi në buxhetin e shtetit. Do të ishte një bashkëpunim shumë i mirë për të parë cilësinë e auditimeve, por, njëkohësisht, për të parë edhe transparencën që audituesit ligjorë do të bëjnë me shoqëritë ekonomike që veprojnë në territorin e Shqipërisë.

Së treti, do të kërkoja të vendosja një marrëdhënie bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, sepse janë dy institucione që kanë një interes të lartë publik. Nëse ne do të arrijmë të kemi objektiva më profesionalë ligjorë, do të kemi mundësi të mbrojmë më mirë interesin publik dhe të ketë një impakt më të mirë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Vënia e fokusit në bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, siç ka qenë Banka Botërore, por dhe me bordet homologe në vendet e huaja, duke e alternuar me trajnime profesionale, do të ishte synim imi që audituesit ligjorë në Shqipëri, të paktën në vendet e Ballkanit Perëndimor, të kishin të njëjtin status, duke i njohur dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Tashmë ne kemi kompani ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, janë mbi 10 kompani të tilla, por është shumë e rëndësishme që audituesit ligjorë dhe profesionistë, që janë edhe nga Shqipëria, të luajnë një rol profesional dhe të zgjerojnë tregun edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ka praktika shumë pozitive që kanë ndodhur në disa vende të tjera. Nuk po flas për BE-në, por flas për rajone të tjera ku audituesit ligjorë luajnë një rol përtej sesa niveli kombëtar. Niveli i trajnimeve për audituesit kontabël duhet të kalojë në një nivel sa më profesional. Bashkë me Institutin e Kontabilistëve të Miratuar, Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ne do të punojmë që të përmirësojmë standardet kombëtare të kontabilitetit në përshtatje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar. Në vitet e fundit është bërë një punë shumë e mirë, ka një përmirësim të ndjeshëm të standardeve kombëtare të kontabilitetit, por puna jonë duhet të vazhdojë edhe më tej për të përmirësuar në mënyrë që edhe niveli ynë të jetë pjesë e integrale e BE-së, të ketë përgatitur të gjithë terrenin, të ketë të gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore, në mënyrë që të përshtatet me të gjitha sfidat që ofron integrimi i BE-së.

Si një anëtar bordi që duhet të punojë në ekip dhe me vendime kolegjiale, duke qenë në disa institucione që kanë vepruar me borde, mendoj se puna në ekip dhe bashkëpunimi që duhet të kemi qoftë brenda bordit, qoftë me institucionet që mbikëqyrin vetë bordin apo dhe me institucionet që mbikëqyr bordi do të ofroja një kontribut të jashtëzakonshëm, në mënyrë që të kem një sinergji pozitive për të arritur qëllimin që duhet të kemi.

Jam në pritje të çfarëdolloj pyetjeje që mund të gjykoni.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Koçi!

Ka pyetje? Nuk ka.

Zoti Gjergji Duro.

(Nuk dëgjohet.)

Atëherë, zoti Klement Mersini.

Zoti Mersini? Nuk përgjigjet.

Zoti Klement, nuk dëgjoheni! Hapeni mikrofonin, ju lutem, se nuk dëgjoheni! Nuk dëgjoheni, nuk dëgjoheni!

Zoti Gjergji! A është zoti Gjergji Duro? Derisa zoti Klement të rregullojë pajisjet, ftojme zotin Gjergji.

Zoti Gjergji!

Gjergji Duro – Po.

Anastas Angjeli – Ju lutem, fjala për juve!

Gjergji Duro – Përshëndetje!

I nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit!

Unë do të flisja shkurtimisht, se mbase ju e keni shqyrtuar dosjen, por jeni edhe të lodhur nga angazhimet e deritanishme.

Shkurtimisht, unë do të them diçka për këtë aplikim, i cili është tërësisht individual. Është e natyrshme që çdo individ të jetë i lidhur me ambiciet e tij profesionale, me avancimin e karrierës apo me vokacionin që vjen nga angazhimi në një bord të tillë, në një institucion të tillë.

Në fakt, asnjë nga këto nuk është më shumë se sa bindja që unë kam për kontributin që mund të jap si anëtar i këtij bordi. Përballja me tatimpaguesit, më lejoni të them se unë jam që prej shtatëmbëdhjetë vjetësh në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duke kaluar të gjitha hallkat dhe sot jam në pozicion drejtues, pra përballja me tatimpaguesit më ka mësuar diçka: që nëse ka vullnet prej tatimpaguesve për të shkëlur, për të shmangur detyrimet tatimore, që bëhet e mundur teknikisht nga ky target-grup, i cili është fokusi i këtij ligji, që janë ekspertët kontabël dhe kontabilistët e miratuar.

Pra, unë mendoj se pjesëmarrja ime në këtë bord do të jetë një element i shtuar në funksion të qëllimit të krijimit të këtij bordi, që ka të bëjë me rritje e sigurisë, rritjen e transparencës së auditimeve ligjore, që këto t'i shërbejnë interesit publik.

Mendoj që, pavarësisht vendimmarrjes tuaj në lidhje me individin, me mua si individ, është e rëndësishme t'i jepet zë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si institucion që duhet të ketë një anëtar në këtë bord. Ky është thjesht mendimi im personal.

Shkurtimisht, kaq kisha për t'ju thënë. Jam i hapur për çdo pyetje, nëse do të keni.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Duro!

Ka ndokush pyetje?

Zonja Mesi, urdhëroni!

Senida Mesi – Përshëndetje!

Përshëndetje edhe juve, zoti Duro!

Në fakt, u nxita nga komenti juaj i fundit, në gjykimin tuaj, ku përmendët që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të ketë një përfaqësues të saj in tek një bord i pavarur. Nuk e di nëse ligji e kuoton qartazi këtë, por me njohuritë e mia, kam përshtypjen se në njëfarë mënyre ka një konflikt interesi. Kjo pasi vetë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është aty për të siguruar dhe garantuar që faturat financiare të depozituara pranë drejtorisë suaj nga subjektet tregtare, pikërisht përballë ligjit duhet të jenë transparente. Mos mendoni se prezenca juaj në një bord të pavarur mund nuk do të krijonte, le të themi, një lloj varësie apo konflikti interesi? Sepse, mendoj që këto dy institucione duhej të ishin komplet të ndara prej njëri-tjetrit, për të ushtruar funksionet respektive: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, aq sa i ka dhënë ligji, Bordi i Mbikëqyrjes të jetë të pavarur, dhe të bëjnë rregullimin e duhur, me qëllim që pasqyra financiare të jetë ashtu sikurse e kërkon ligji me të cilin bëni edhe ju monitorim.

Faleminderit!

Gjergji Duro – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, mendoj se unë do të jem anëtar i bordit, dhe bordi nuk ka funksione administrative, që të merret direkt me kontrollin e këtyre personave. Unë thjesht do të përçoj aty një frymë, një dëshirë për t'i bërë gjërat më mirë. Nuk ka ndonjë kriter të shprehur në ligj, i cili do ta ndalonte këtë gjë.

Megjithatë, unë dua të shtoj edhe diçka tjetër, një argument plotësues: që në të gjitha konsulencat që Fondi Monetar i ka dhënë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe ministrisë, është shprehur në mënyrë të theksuar rritja e bashkëpunimit dhe ndërveprimi që duhet të ketë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me organizatat profesionale në këtë fushë. Unë mendoj se kjo përbën një nga elementet që jep një argument shtesë në lidhje me kandidimin që kam paraqitur.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Duro!

Nga ana tjetër, në kriteret e shpallura nga Ministria e Financave, nuk ka ndonjë çështje konflikt interesi për ata që kandidojnë në këtë mënyrë. Kanë vënë disa kritere, por mes tyre nuk përfshihet ky lloj kriteri.

I fundit në këtë diskutim është zoti Klement.

A është zoti Klement gati apo jo, me teknologjinë e tij?

Zoti Duro, faleminderit!

Mund të largoheni.

Zoti Klement Mersini, jeni gati apo s'jeni?

Zoti Klement, mund të futeni nga telefoni, se nuk dëgjoheni, dhe ne nuk mund të rrimë pa fund.

Jeni gati, zoti Klement?

Nuk mund të bëjmë një seancë tjetër. Ne do të donim të të dëgjonim. Dosjen tënde e kemi. Do ta konsiderojmë sikur e kemi bërë dëgjesën, nëpërmjet dosjes që ke paraqitur, por s'kemi çfarë të bëjmë. Nuk na e dhe mundësinë të të dëgjonim me gojë pesë minuta.

Atëherë, anëtarë të komisionit, ju falënderoj për këtë mbledhje të gjatë, për gjithë vëmendjen tuaj, për gjithë kontributin tuaj.

Javën e ardhshme mund të kemi një mbledhje. Do t'ju njoftojmë.

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti